

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIII, nr. 6994  
E mërkurë, 13 shtator 2023  
Çmimi 0.40 €

## Dëshmitari në Hagë: Thaçi punoi me LDK-në për të mirën e Kosovës

FAQE 5



Na ndiqni edhe në:


[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

ME URDHËR TË ZYRËS SË PROKURORIT TË SPECIALIZUAR (SPS) NË HAGË  
BASTISËT BANESA E FAMILJARËVE TË HERONJVE FAHRI DHE BAHRI FAZLIU

# SPECIALJA VAZHDON GJAHUN NDAJ UÇK-së, BASTIS BANESËN E FAMILJARËVE TË HERONJVE FAZLIU



**FAHRI FAZLIU I RI:  
DO T'I PËRBALLOJMË  
EDHE KËSAJ FURTUNE!  
BALLËHAPUR,  
KOKËLARTË DHE  
GJITHMONË KRENARË  
ME TË KALUARËN  
TONË TË LAVDISHME!**

Policia e EULEX-it, me urdhër të ZPS në Hagë, ka bastisur të martën në mëngjes banesën e familjes së heronjve të kombit Fahri dhe Bahri Fazliu. Përpos spektaklit, avokati i familjes Fazliu, Artan Qerkin, ka thënë se gjatë kësaj bastisje nuk është sekuestruar asnjë provë e

vetme e cila mund të jetë relevante. Ndërsa vëllai i heronjve Fahri dhe Fahri Fazliu, Fadili, ka bërë me dije se gjatë bastisjes ia kanë marrë telefonin dhe laptopin e punës. Po ashtu, ai ka bërë me dije se edhe djalinë të tij, Fahriut, i është marrë telefoni, edhe pse në

vendim nuk ishte evidentuar që të konfiskohet. Fadil dhe Fahri Fazliu kanë thënë se nga banesa e tyre kanë dalë shumë heronj dhe luftëtarë lirë. Ata kanë thënë se do ta përballojnë edhe këtë furtunë dhe se janë krenarë për të kaluarën e tyre të lavdishme

## JOSEPH: KURTI DHE VUÇIQI PËRFITOJNË NGA KRIZA NË VERI

FAQE 4-5



## BE-JA ZBARDH AGJENDËN E TAKIMEVE NË BRUKSEL PËR DIALOGUN KOSOVË - SERBI

FAQE 5



## EKONOMI



MË 19 SHTATOR MBAHET ANKANDI  
I TETË I LETRAVE ME VLERË PËR  
KËTË VIT

THEMLOHET LIDHJA E BIZNESEVE  
TË KOSOVËS

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegjibiznesi.com](http://www.kolegjibiznesi.com)  
info@kolegjibiznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...



# Betohen ministrat e rinj të qeverisë Rama

TIRANË, 12 SHTATOR - Ministrat e rinj, Arbjan Mazniku, Albana Koçiu, Igli Hasani, Ogerta Manastirliu dhe Anila Denaj, kanë dhënë të martën betimin para presidentit të Shqipërisë, Bajram Begaj. Një ditë më parë dekretet e ministrave të ri rinj janë miratuar në Kuvend në një seancë të posaçme plenare.

Arbjan Mazniku i propozuar ministër i Shtetit për Pushtetin

Vendor ka marrë 73 vota për, 35 kundër dhe asnjë abstenim. Albana Koçiu, e propozuar në pozicionin e ministres së Shëndetit dhe Mirëqenies Sociale, ka marrë 73 vota për, 1 abstenim dhe 32 kundër. Igli Hasani, i propozuar nga Rama për pozicionin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, ka siguruar në Kuvend 74 vota për, 33 kundër dhe asnjë abstenim.

Ogerta Manastirliu, e propozuar në pozicionin e ministres së Sportit, ka marrë 72 vota për, 35 kundër dhe një abstenim. Anila Denaj, e propozuar në pozicionin e ministres së Bujqësisë dhe Zhvillimit, ka siguruar 73 vota për, 27 kundër dhe asnjë abstenim. Propozimi i ministrave të rinj është bërë disa ditë më parë nga kryeministri Edi Rama.



## Figura të larta palestineze i dënojnë deklaratat antisemitike të Abbasit

JERUSALEM, 12 SHTATOR - Rreth 190 akademikë palestinezë, artistë dhe aktivistë, e kanë dënuar ashpër fjalimin antisemit të presidentit Mahmoud Abbas përmes një letre të hapur. Grupi ka thënë se i dënon komentet e bëra nga Abbasi për Holokaustin. "Me rrënjë të thella në teorinë racore të përhapur në kulturën evropiane në atë kohë, gjenocidi nazist ndaj popullit hebre ka lindur nga antisemitizmi, fashizmi dhe racizmi. Ne i kundërshtojmë të gjitha përpjekjet për ta keqinterpretuar apo justifikuar antisemitizmin dhe krimet naziste kundër njerëzimit", është thënë në letër.



Abbas ka nxitur kritika ndërkombëtare kur në fund të gushtit, para anëtarëve të partisë së tij Fatah, ka thënë se "ju mendoni se Hiliteri i ka vrarë hebrejtë për shkak se janë hebrej, dhe se Evropa i ka urreyer hebrejtë sepse janë hebrej. Nuk është ashtu. Evropianët i kanë luftuar këta njerëz për shkak të rolit të tyre në shoqëri, që ka pasur të bëjë me fajde, para e kështu me radhë". Autorët e "Letrës së Hapur Palestineze" kanë shkruar se "populli palestinez është dëmtuar shumë nga kolonializmi, shpronësimi, pushtimi dhe shtypja izraelite, pa pasur nevojë të preket edhe nga

ndikimi negativ i këtyre narrativave antisemitike, të nxitura nga personat që pretendojnë se flasin në emrin tonë". Ata kanë thënë se janë duke u dëmtuar edhe nga "regjimi autoritativ" i Autoritetit Palestinez, i cili ndikon në jetët e atyre që janë "nën-pushtim". Ndonëse Abbas konsiderohet figurë kontroverze nga shumë palestinezë, kjo formë e kritikës së hapur nga figura të njohura palestineze ndaj tij është e pazakonshme. Zgjedhjet e fundit presidenciale në Autoritetin Palestinez janë mbajtur më 2005, ndërsa ato parlamentare më 2006.

## Putini: Pushtimet sovjetike të Hungarisë dhe Çekosllovakisë ishin të gabuara



MOSKË, 12 SHTATOR - Presidenti rus Vladimir Putin ka thënë se pushtimi i Hungarisë dhe Çekosllovakisë në kohën sovjetike ka qenë gabim. Duke folur në një forum në lindje të Rusisë, ai ka thënë se nuk është e drejtë asgjë

në politikë të jashtme që i dëmton interesat e njerëzve të tjerë. Ai i ka bërë këto deklaratat teksa ushtria ruse vazhdon të luftojë në Ukrainë. Bashkimi Sovjetik e ka pushtuar Hungarinë më 1956 dhe Çekosllovakinë më 1969, pas protestave masive dhe kërkesave për më shumë liri. Presidenti rus i ka bërë këto deklaratat në Forumin Ekonomik Lindor që po mbahet në qytetin lindor të Rusisë, Vladivostok. Një moderator e ka pyetur se si do të përgjigjej ndaj atyre që thonë se Bashkimi Sovjetik ka vepruar si

fuqi koloniale kur i ka dërguar tanket në Pragë më 1969 dhe në Budapest më 1956. "Ne e kemi pranuar që një kohë të gjatë se disa pjesë të politikave sovjetike kanë qenë të gabuara dhe vetëm kanë çuar në tensionim të marrëdhënieve. Nuk duhet bërë asgjë në politika të jashtme që janë në kundërtë me interesat e njerëzve të tjerë", ka thënë Putini. Sipas tij, vendet perëndimore, sidomos Shtetet e Bashkuara, janë duke e bërë tani gabimin që e kanë bërë dikur sovjetikët. "Ato u bëjnë presion aleatëve, të ashtuquajtur

partnerë. Ato nuk kanë miq. Ato kanë interesa. Kjo është vazhdimësi e të ashtuquajturës formulë britanike", ka thënë ai. Komentet e Putinit për veprimet e Bashkimit Sovjetik në Hungari dhe Çekosllovakia janë ndryshe prej pikëpamjeve të rrethit të tij të ngushtë. Në gusht, një tekst të historisë, të shkruar nga një prej këshilltarëve të Putinit, Vladimir Medinsky, pretendohet se Revolucioni Hungarez i vitit 1956 ka qenë kryengritje fashiste e organizuar nga Perëndimi dhe se tërheqja e trupave sovjetike nga Hungaria

më 1990 ka qenë vendim i gabuar. Politikanët dhe historianët hungarezë e kanë kritikuar këtë tekst. Ministri i Jashtëm hungarez, Peter Szijjarto, pati thënë se "ka çështje të historisë së Hungarisë për të cilat as nuk duam të debatohet me askënd. Revolucionarët e vitit 1956 janë heronjtë tanë". Bashkimi Sovjetik është shpërbërë më 1991, ndërsa Çekosllovakia është ndarë në dy shtete, Republikën Çeke dhe Sllovakinë, me një vendim që ka hyrë në fuqi më 1 janar të vitit 1993.

## Mijëra persona dyshohet se kanë vdekur nga stuhia në Libi

TRIPOLI, 12 SHTATOR - Mijëra persona besohet se kanë vdekur si pasojë e një stuhie të fuqishme që ka shkakuar përmbytje shkatërruese në Libi. Lideri i qeverisë në lindje të Libisë, e cila nuk njihet ndërkombëtarisht, ka thënë se numri i vdekjeve mund të shkojë në 2 000, ndërsa mijëra njerëz të tjerë vazhdojnë të jenë të zhdukur.

Stuhia "Daniel" ka zbarkuar në Libi të dielën, duke i detyruar autoritetet të shpallin gjendje të jashtëzakonshme. Shtatë pjesëtarë të ushtrisë së Libisë janë zhdukur në operacionet e kërkim-shpëtimit. Zyrtarët në lindje kanë nisur të zbatojnë orë policore, ndërsa shkollat dhe dyqanet janë mbyllur. Teksa numri i

viktimit rritet, Kryqi i Kuq i Libisë ka thënë se të paktën 150 shtëpi janë shkatërruar. Ndonëse administrata me bazë në Bengazi është marrë me situatën në lindje të shtetit, rivalja e saj, qeveria e njohur nga komuniteti ndërkombëtar në Tripoli, është përfshirë, po ashtu. Kryeministri Abdulhamid Dbeiba ka thënë se i ka

urdhëruar të gjitha agjencitë shtetërore që t'i adresojnë dëmet pas përmbytjeve, derisa Zyra e Kombeve të Bashkuara në Libi ka thënë se është duke e vëzhguar situatën nga afër. Libia është ndarë në dy administrata rivale prej vitit 2014, pas vrasjes së liderit Muammar Gaddafi më 2011. Të dyja qeveritë i kanë shpallur tri ditë zie për t'i nderuar viktimat e



stuhisë "Daniel". Shkencëtarët për klimën kanë tërhequr vërejtjen se ndryshimet klimatike nënkuptojnë më shumë sasi të ujit gjatë sezonit veror, që mund të rezultojë me stuhi intensive.



ME URDHËR TË ZYRËS SË PROKURORIT TË SPECIALIZUAR (SPS) NË HAGË BASTISET  
BANESA E FAMILJARËVE TË HERONJVE FAHRI DHE BAHRI FAZLIU

# Specialja vazhdon gjahun ndaj UÇK-së, bastis banesën e familjarëve të heronjve Fazliu

**- Fahri Fazliu i ri: Do t'i përballojmë edhe kësaj furtune! Ballëhapur, kokëlartë dhe gjithmonë krenarë me të kaluarën tonë të lavdishme!**

Policia e EULEX-it, me urdhër të ZPS në Hagë, ka bastisur të martën në mëngjes banesën e familjes së heronjve të kombit Fahri dhe Bahri Fazliu. Përpos spektaklit, avokati i familjes Fazliu, Artan Qerkini, ka thënë se gjatë kësaj bastisje nuk është sekuestruar asnjë provë e vetme e cila mund të jetë relevante. Ndërsa vëllai i heronjve Fahri dhe Bahri Fazliu, Fadili, ka bërë me dije se gjatë bastisjes ia kanë marrë telefonin dhe laptopin e punës. Po ashtu, ai ka bërë me dije se edhe djalit të tij, Fahriut, i është marrë telefoni, edhe pse në vendim nuk ishte evidentuar që të konfiskohet. Fadil dhe Fahri Fazliu kanë thënë se nga banesa e tyre kanë dalë shumë heronj dhe luftëtarë lirije. Ata kanë thënë se do ta përballojnë edhe këtë furtunë dhe se janë krenarë për të kaluarën e tyre të lavdishme

EPOKA  
ERE

Lirim GECI

**PRISHTINË, 12 SHTATOR** - Policia e EULEX-it, në bashkëpunim me Zyrën e Prokurorit të Specializuar (ZPS) në Hagë, për pesë orë kanë bastisur të martën banesën e familjarëve të heronjve Fahri dhe Bahri Fazliu, e cila gjendet në lagjen "Kodra e Diellit" në Prishtinë.

Lajmin e kanë dhënë familjarët e heronjve Fazliu dhe avokati i tyre, Artan Qerkini, i cili në një konferencë për medie me Fadil dhe Fahri Fazliun, ka thënë se gjatë kësaj bastisje nuk është sekuestruar asnjë provë e vetme e cila mund të jetë relevante. Avokati Qerkini këtë aksion të EULEX-it dhe të ZPS-së e ka quajtur të kotë. "Dhomat e Specializuara sot kanë realizuar bastisjen në shtëpinë e heronjve kombëtarë Fahri dhe Bahri Fazliu, me ç'rast janë munduar që kinse të sekuestrojnë prova të cilat atyre u nevojiten për procedura të mëtutjeshme. Mirëpo, unë jam i bindur se ata nuk kanë sekuestruar asnjë provë të vetme dhe se ka qenë një bastisje e kotë dhe humbje kohe

për të gjithë ata", ka thënë Qerkini.

Më tutje, avokati ka thënë se arsyeja e këtij aksioni nuk është bërë me dije. Sipas tij, zyrtarët e EULEX-it dhe të ZPS-së u kanë thënë se këtë bastisje janë duke e bërë për nevojat e procedurave të cilat janë duke u zhvilluar në Gjykatën Speciale në Hagë. "Konsideroj se gjykata duhet të jetë e kujdesshme në lëshimin e urdhrave për bastisje sepse cenohet privatësia, në anën tjetër, siç ndodhi në rastin konkret, nuk kanë sekuestruar asnjë provë me relevancë për procedurën penale dhe procedurat të cilat janë në rrjedhë e sipër pranë Dhomave të Specializuara. Rasti nuk është bërë i ditur dhe vetëm është thënë se për nevojat e procedurave të cilat janë duke u zhvilluar pranë Dhomave të Specializuara. Detaje të tjera në lidhje me këtë nuk kanë dhënë farë", ka thënë Qerkini, duke shtuar se dokumentet të cilat janë marrë nga banesa e familjarëve të dëshmorëve Bahri dhe Fahri Fazliu janë publike për çfarë, sipas tij, nuk ka pasur nevojë të kryhet bastisja. "Ata i kanë marrë disa dokumente të cilat janë



publike. Realisht nuk ka pasur nevojë fare të bastisjet shtëpia për të ardhur deri tek ato dokumente sepse janë dokumente publike. Trajtimi ka qenë korrekt dhe nuk kemi asnjë vërejtje në lidhje me trajtimin, mirëpo me mënyrën e urdhërimit të bastisjes kemi shumë vërejtje sepse me bastisje cenohet privatësia", ka thënë Qerkini.

Ndërsa pronari i banesës dhe vëllai i heronjve Fahri dhe Bahri Fazliu, Fadili, ka bërë me dije se EULEX-i ia ka marrë telefonin dhe laptopin e punës. Po ashtu, ai ka bërë me dije se i është marrë edhe telefoni i djalit të tij, Fahriut, edhe pse në vendim nuk ishte evidentuar të konfiskohet. Pavarësisht kësaj, Fazliu ka pohuar se sjellja e pjesëtarëve të EULEX-it ka qenë korrekte dhe se nuk kanë kërkuar diçka konkrete përpos që kanë kontrolluar. "Telefoni që ka fotografi familjare e shoqërore, laptopin e punës që punoj në KEDS. Më erdh keq që edhe telefonin e djalit e morën. Nuk e kishin në letër", ka thënë Fazliu, duke shtuar se banesa e tij ka qenë bazë e UÇK-së. "Sot është banesë e të gjithëve. Nuk ka kryeministër që s'ka qenë këtu. Sjellja e tyre ka qenë korrekte. Të

gjitha dokumentet që i kanë marrë i kanë kthyer në vend. Kanë kontrolluar, ka pasur foto dhe dokumente të UÇK-së, por nuk u interesuan", ka thënë Fazliu.

Në anën tjetër, nipi i heronjve

familjare, në përvjetorë, kanë qëndruar këtu. Unë kam qenë i ftuar nga Specialja tri vjet në cilësinë e dëshmitarit, por e kam përfunduar. Nuk besoj që bastisja sot mund të ketë lidhje me atë", ka thënë Fahri Fazliu.

Fahriu i ri ka thënë se është krenar për të kaluarën e lavdishme të familjes Fazliu dhe të UÇK-së. "Do t'i përballojmë edhe kësaj furtune! Ballëhapur, kokëlartë dhe gjithmonë krenar me të kaluarën tonë të lavdishme! 'Erërat lëkundin degët, por trungun jo'. Lavdi gjithë dëshmorëve dhe heronjve të kombit. Respekt për gjithë luftëtarët e lirisë!", ka thënë Fazliu. Lidhur me bastisjen e EULEX-it dhe ZPS-së në banesën e familjes së heronjve Fazliu ka reaguar ushtruesi i detyrës i kryetarit të OVL-UÇK-së, Faton Klinaku. Ai ka thënë se Zyra e Prokurorit të Specializuar është e poshtër, duke shtuar se në mungesë të fakteve është duke i vazhduar "filmata" të tillë. "Zyra e Prokurorit të



Fahri dhe Bahri Fazliu, Fahriu i ri, ka thënë se nga banesa e babait të tij kanë dalë shumë heronj të tjerë të Kosovës. "Rreth orës 7:00 të mëngjesit ka filluar bastisja e banesës. Prej kësaj banese kanë dalë shumë heronj të tjerë. Nuk di që ka diçka si ditar apo gjëra personale. Të gjithë ata që janë në Hagë kanë qenë këtu për vizitë

Specializuar në Hagë, në mungesë të fakteve, vazhdon me filma. Që në orët e para të mëngjesit të sotëm ka filluar bastisjen e banesës së familjes së heronjve Fahri dhe Bahri Fazliu në 'Kodrën e Diellit' në Prishtinë. P.S: ZPS janë të poshtër, meqenëse nuk ka shtet serioz", ka shkruar Klinaku në "Facebook".







FLET EDWARD JOSEPH, LIGJËRUES NË UNIVERSITETIN "JOHNS HOPKINS" NË UASHINGTON

## Kurti dhe Vuçiqi përfitojnë nga kriza në veri

Ligjëruesi në Universitetin "Johns Hopkins" në Uashington, Edward Joseph, ka thënë se nuk ka pritje të mëdha nga takimi i kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti dhe presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, i cili do të mbahet nesër (e enjte) në Bruksel. Ai ka thënë se BE-ja duhet t'ua rikujtojë Kurtit dhe Vuçiqit se Kosova dhe Serbia kanë arritur një marrëveshje e cila duhet të zbatohet. Në këtë kontekst, ai ka thënë se Kurti dhe Vuçiqi janë duke përfituar nga kriza në veri

UASHINGTON, 12 SHTATOR - Edward Joseph, ligjërues në Universitetin "Johns Hopkins" në Uashington, ka thënë se nuk ka pritje të mëdha nga takimi i kësaj jave në mes të kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, dhe presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, i pari pas më shumë se katër muajsh. Sipas tij, do të ishte "befasi e këndshme" nëse do të kishte ndonjë përparim. Duke folur në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë", Joseph ka thënë se bashkimi Evropian, si ndërmjetësues i dialogut, duhet t'ua kujtojë të dyja vendeve se kanë një marrëveshje për të zbatuar. Për zgjidhjen e situatës në veri të Kosovës, ai ka thënë se të gjitha palët duhet t'i luajnë rolet e veta. Por, Joseph ka thënë se kriza i përshtatet Vuçiqit dhe Kurtit.

"Vuçiqi përfiton nga gjithçka që e pengon ta zbatojë marrëveshjen që ShBA-ja dhe BE-ja thonë se e ka pranuar (për normalizimin e marrëdhënieve me Kosovën)... Kurti sigurisht përfiton, sepse

presioni tani është vetëm për hapat e shtensionimit (të situatës në veri) dhe jo te çështja e Asociacionit...", thotë Joseph. Sipas tij, Vuçiq nuk është partner i ShBA-së, por edhe Kurti "ka qenë jashtëzakonisht i vështirë dhe i papërgjegjshëm në qasjen e tij ndaj veriut" dhe "kjo nuk është në përputhje me të qenët partner i mirë me Shtetet e Bashkuara dhe Perëndimin".

*Një takim në mes të kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, dhe presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, do të mbahet më 14 shtator. Për herë të fundit ata janë takuar më 2 maj. Çfarë prisni nga takimi i radhës?*

**Edward Joseph:** Nuk mendoj se mund të presim shumë përparim. Kjo nuk do të thotë se nuk ka mundësi për asnjë përparim por, thjesht, nuk duhet të kemi pritje shumë të mëdha. Do të befasohemi këndshëm, nëse do të ketë përparim. Ajo që është e rëndësishme të dalë nga ky takim, është që Brukseli ta

kujtojë secilin se ka një marrëveshje midis Kosovës dhe Serbisë. Është e rëndësishme për BE-në që të ndalojë së foluri për dialogun, sepse ka një marrëveshje, një marrëveshje që ka ofruar Brukseli dhe që është arritur në shkurt. Ka, po ashtu, një aneks që i adreson të gjitha çështjet e zbatimit të saj, (për të cilin është rënë dakord në Ohër). Dhe, është e rëndësishme që BE-ja t'i kthehet asaj dhe t'i kujtojë palët se - sipas vetë BE-së dhe ShBA-së janë të detyruara ta zbatojnë.

*Situata në veri të Kosovës mbetet e pazgjidhur. Në fushën e kujt është topi tani?*

**Edward Joseph:** Topi është në fushën e BE-së dhe të ShBA-së për të dalë nga kjo [situatë]. Ne mund ta drejtojmë gishtin e fajit kah Albin Kurti, i cili kritikohet ashpër edhe në Kosovë, nga opozita e tij, për veprimet e pamatura, për tendosjen e marrëdhënieve me ShBA-në dhe me BE-në, për refuzimin e planit

të BE-së për shtensionimin (e situatës në veri) dhe për ndëshkimet që kanë goditur Kosovën për shkak të veprimeve të tij. Pra, qartazi, Kurti ka faj. Por, kjo nuk do të thotë se Aleksandër Vuçiqi është i pafajshëm dhe se topi nuk është, gjithashtu, në fushën e tij. Sepse Vuçiqi ka një rol të madh në krijimin e kësaj krize.

Kur flasim për topin në fushë, mendohet se vetëm një aktor duhet të veprojë, por kjo nuk është e vërtetë. Vuçiqi ka pasur një rol jashtëzakonisht të madh në krijimin e kësaj krize, duke mos bërë asgjë kundër bojkotimit të zgjedhjeve (në veri të Kosovës nga ana e serbëve lokalë). Këtë e ka bërë pas Marrëveshjes së Ohrit, me të cilën Kurti është pajtuar në parim për krijimin e Asociacionit (të Komunave me Shumicë Serbe), gjë të cilën ka thënë se nuk do ta bëjë kurrë. Pra, nuk mund të thuhet se topi është në fushën e Kurtit dhe nuk është në fushën e Vuçiqit. Është vërtet në fushën e BE-së dhe të ShBA-së. Ato duhet të jenë serioze për këtë, të sigurojnë se kanë një marrëveshje dhe të marrin hapa për t'i mbajtur palët të përkushtuara në zbatimin e asaj marrëveshjeje.

*Atëherë, kush mendoni se përfiton nga krizat e vazhdueshme në veri?*

**Edward Joseph:** Po ju them se

kush nuk përfiton dhe ata janë të gjithë qytetarët e Kosovës që jetojnë në veri: serbë, shqiptarë, boshnjakë... Ata sigurisht që nuk përfitojnë. Por, përfitojnë të gjithë ata që janë përfitues të status quo-së. Ata përfshijnë strukturat në veri të cilat përfitojnë nga fakti që nuk ka sundim të qëndrueshëm të ligjit në zonë. Politikisht, unë do të thosha se Aleksandër Vuçiqi përfiton nga gjithçka që e pengon ta zbatojë marrëveshjen që ShBA-ja dhe BE-ja thonë se e ka pranuar. Kurti sigurisht përfiton, sepse presioni tani është vetëm për hapat e shtensionimit (të situatës në veri) dhe jo te çështja e Asociacionit.

*Po flisni për shtensionimin... Autoritetet e Kosovës kanë shprehur gatishmërinë e tyre për t'i mbajtur zgjedhjet e reja në veri. A mendoni se serbët lokalë do të merrnin pjesë në atë proces?*

**Edward Joseph:** Vuçiqi e ka mbështetur bojkotimin e zgjedhjeve [në prill] edhe pas Marrëveshjes (së Ohrit) në mars. Ajo ka qenë koha për ta ndryshuar politikën, për të parë nëse janë në një epokë të re. Nuk e di përgjigjen në pyetjen tuaj. Të ndalemi pak te politika evropiane dhe amerikane. Një grup i politikanëve evropianë dhe amerikanë u ka dërguar një letër udhëheqësve të ShBA-së dhe BE-së, duke iu kërkuar ta



## BE-ja zbardh agjendën e takimeve në Bruksel për dialogu Kosovë - Serbi

Bruksel, 12 shtator - Nesër (e enjte) në Bruksel do të takohen kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, dhe presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, në praninë e përfaqësuesit të lartë të

Bashkimit Evropian, Josep Borrell dhe emisarit për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak.

Në njoftimin e BE-së është bërë me dije se fillimisht Borrelli dhe Lajçaku do të kenë

takim ndaras me Kurtin dhe Vuçiqin, pastaj do të pasojë takimi trepalësh.

Më tutje, BE-ja ka njoftuar se takimet ndaras do të nisin në orën 09:00, pastaj do të jetë takimi trepalësh. "Takimi do të

jetë i fokusuar në zbatimin e marrëveshjes për rrugën drejt normalizimit, si dhe çështjet aktuale", është thënë në njoftim.

Pas takimeve është paralajmëruar deklaratë për



medie nga kryediplomati evropian Josep Borrell.

## Dëshmitari në Hagë: Thaçi punoi me LDK-në për të mirën e Kosovës

Hagë, 12 shtator - Në gjykimin ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit në Dhomat e Specializuara të Kosovës (DhSK), dëshmitari i 24-të (me kodin 4255), ka pohuar se Thaçi ka punuar pas luftës krah për krah me të dhe pjesëtarë të LDK-së për të mirën e Kosovës. Këtë deklaratë ai e ka thënë duke u përgjigjur në pyetjet e avokatit mbrojtës të Hashim Thaçit, Gregory Kehoe. Fillimisht, seanca ka qenë private dhe pyetjet lidhur me veprimtarinë e pas luftës, avokati Kehoe i ka bërë në seancë publike.

Dëshmitari vetëm e ka pohuar atë që ka thënë avokati Kehoe dhe atë se në vitet 2001-2004 Thaçi si kryetar i PDK-së është bashkuar me Ibrahim Rugovën, duke e lënë Bajram Rexhepin të bëhet kryeministër i Kosovës. Thaçi ishte ai që e ka mbështetur

Rugovën të bëhet president dhe se në vitet 2004-2007 ishte opozitë me PDK-në, u pajtua të bëhej me ekipin e Ibrahim Rugovës për të bërë negociata për statusin e Kosovës sa ishte gjallë Rugova, e që më pas ky grup është kryesuar nga një udhëheqës tjetër i LDK-së, Fatmir Sejdiu dhe se ka punuar me të ndonjëse ishte në opozitë. Më tutje, është thënë se në vitet 2007-2010 Thaçi ka fituar zgjedhjet parlamentare dhe është bërë kryeministër, por s'e ka ftuar LDK-në për t'iu bashkuar në koalicion për ta formuar qeverinë dhe se Fatmir Sejdiu është bërë president i Kosovës.

Në vazhdim është thënë se në vitet 2014-2017, kur Thaçi kishte fituar zgjedhjet, e kishte marrë LDK-në si pjesë të koalicionit, duke ia dhënë pozitën e kryeministrit Isa Mustafës, ndërkohë vetë ishte bërë



zëvendës i Mustafës dhe se në vitin 2016, kur është zgjedhur president, LDK-ja ka votuar në favor të tij.

Si përfundim, dëshmitari ka pohuar se tërë këtë periudhë Thaçi ka punuar krah për krah me të dhe pjesëtarë të LDK-së për

të mirën e Kosovës. Pas kësaj, seanca ka vazhduar me marrjen në pyetje të dëshmitarit nga mbrojtja e Veselit, konkretisht nga avokati Ben Emmerson. Ai ka lexuar një pjesë nga deklarata e dhënë e dëshmitarit për ZPS-në, kur ishte pyetur se në periudhën

e 1998-1999 a e ka njohur Kadri Veselin, ishte përgjigjur "atë s'e ka njohur kurrkush" dhe se në pyetjen nëse gjatë konfliktit kishte dëgjuar ndonjëherë për të është përgjigjur: "Jo, asnjëherë". Sipas dëshmitarit, këto përgjigje janë të sakta dhe të vërteta. Kurse në momentin kur avokati donte të bënte pyetje në bazë të hartës ku përfshihet zona përgjegjëse e dëshmitarit, me rekomandim edhe të prokurorit special, James Pace, seanca ka kaluar në sesion privat me qëllim që të mbrohet dëshmitari.

Procesi gjyqësor ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit ka filluar më 3 prill të vitit 2023. Ata janë duke u mbajtur në paraburgim që nga nëntori i vitit 2020. Katërshja e UÇK-së është deklaruar e pafajshme në raport me akuzat me të cilat është ngarkuar nga ZPS-ja.

## Emisari gjerman për vizat: Nga 1 janari do të bëhet ashtu siç është premtuar



PRISHTINË, 12 SHTATOR - I dërguari i posaçëm i Gjermanisë për Ballkanin Perëndimor, Manuel Sarrazin, ka thënë se për Gjermaninë vizat nuk janë më çështje e diskutueshme. Në këtë kontekst, ai ka thënë se nga 1 janari do të bëhet ashtu siç është premtuar. Sarrazin ka komentuar

deklaratën e presidentit francez Emmanuel Macron sa iu përket vizave për qytetarët e Kosovës.

Ai ka theksuar se ky nuk është një opsion dhe do të ishte një gabim i madh sepse vetëm do t'i largonte kosovarët nga procesi i BE-së. "Sa i përket heqjes së vizave, ju e dini se ka pasur

një deklaratë të presidentit Macron. Dua ta them qartë se ky nuk është një opsion dhe do të ishte një gabim i madh sepse vetëm do t'i largonte kosovarët nga procesi i BE-së. Dhe e themi se 1 janari 2024 do të bëhet ashtu siç është pajtuar dhe premtuar. Nëse ne themi se Albin Kurti dhe Aleksandër

Vuçiqi duhet t'i përmbushin premtimet sa i përket shtetësisë ne nuk do të bëhemi më të mirë nëse nuk i përmbushim premtimet tona. Kultura e mospërmbushjes së premtimeve dhe të programeve që janë pajtuar është problem në rajon", ka thënë ai për "RTV21".

shqyrtojnë qasjen e tyre për uljen e tensioneve midis Kosovës dhe Serbisë. Ata kanë kritikuar "mungesën e presionit ndaj Serbisë".

Çfarë mendoni ju për këto kritika?

**Edward Joseph:** Letra u ka bërë jehonë shumë kritikave që unë kam nxjerrë në artikullin tim, të publikuar në qershor, në gazetën "Foreign Policy", me titullin "ShBA-ja po krijon krizë në Kosovë". Ajo ka reflektuar kritikën që unë kam ngritur për qasjen e BE-së dhe të ShBA-së pas dhunës së 29 majit (në Zveçan, në veri të Kosovës). Sulmet e serbëve kundër ushtarëve të KFOR-it (misionit të NATO-s në Kosovë) kanë qenë shumë serioze. Dhe reagimi, siç e kam thënë në atë artikull, ka qenë pothuajse tërësisht i njëanshëm. Vetëm Kurti është fajësuar për këtë, ndërsa dhuna është kryer nga serbët. Dhuna ka përfshirë koktejl molotovi që, qartazi, është dashur të përgatiten paraprakisht. Kjo do

të thotë se ky lloj i dhunës ka qenë i planifikuar. Kjo sugjeron fuqishëm se Beogradi ka qenë në dijeni, se burimet e tij kanë qenë, sipas të gjitha gjasave, në dijeni, dhe presidenti Vuçiq nuk ka bërë asgjë për ta ndaluar atë. Ai sigurisht se e ka ditur për kërcënimin e dhunës dhe nuk ka ndërmarë hapa për ta ndaluar atë. Dhe, ShBA-ja dhe BE-ja kanë reaguar në mënyrë të konsiderueshme kundër Kurtit dhe e kanë lavdëruar Vuçiqin, duke e konsideruar partner. Pra, letra u bënë jehonë shqetësimeve të mia për këtë dhe të kuptuarit më të gjerë se ky nuk është vetëm problem i Albin Kurtit, që është oportunist dhe populist dhe vepron në mënyrë të pamatur, duke injoruar përgjegjësitë e tij për t'u koordinuar, për të respektuar atë që NATO-ja thotë në lidhje me dislokimin në veri, por reflekton edhe mosgatishmërinë për t'u marrë me rolin e Aleksandër Vuçiqit në Kosovë dhe me faktin se ai nuk do zgjidhje.

Atëherë, kush mund të konsiderohet partner i afërt i Perëndimit, Kurti apo Vuçiqi, dhe pse?

**Edward Joseph:** Kjo ngre një pyetje më të gjerë. Albin Kurti ka qenë jashtëzakonisht i vështirë dhe i papërgjegjshëm në qasjen e tij ndaj veriut. Kjo nuk është në përputhje me të qenët partner i mirë me Shtetet e Bashkuara dhe Perëndimin. Por, Kosova është në linjë me ShBA-në dhe mbështet ShBA-në sa i përket kërcënimit më të madh të sigurisë në Evropë, në këtë shekull, e që është pushtimi i Ukrainës nga Rusia. Aleksandër Vuçiqi nuk është partner i ShBA-së, pavarësisht faktit se disa zyrtarë amerikanë vazhdojnë të thonë se ai është partner gjithnjë e më i mirë i ShBA-së. Ai nuk është. Ai vazhdon të jetë edhe partner i Vladimir Putin (presidentit rus). Ai e ka dëshmuar këtë në disa aspekte. Ai refuzon ta shkarkojë Aleksandër Vulinin [drejtorin e Agjencisë së Sigurisë dhe

Informacionit në Serbi], edhe pse ai është sanksionuar nga Shtetet e Bashkuara. Vulin është bashkëpunëtor i hapur i Rusisë, dhe jo si Vuçiqi që është bashkëpunëtor më delikat. Serbia mbështet dhe është nikoqire e (medimeve ruse) "Russia Today", "Sputnik", promovon narrativa pro-ruse, ka tregti të gjerë, ka fluturime me Rusinë. Pra, Aleksandër Vuçiqi nuk është partner i Shteteve të Bashkuara, në çështjet tona më të rëndësishme të politikës së jashtme, dhe nuk është partner as sa i përket arritjes së vërtetë të stabilitetit demokratik në rajon.

Deri kur mendoni se Perëndimi do t'i tolerojë autoritetet serbe që të mos e sanksionojnë Rusinë [për shkak të pushtimit të Ukrainës]?

**Edward Joseph:** Mendoj se mbetet një pyetje e hapur në administratë. Mendoj se disa zyrtarë janë nën iluzionin se Aleksandër Vuçiq mund të jetë partner ose është tashmë partner i Shteteve të Bashkuara,

ndërsa të tjerë nuk e kanë këtë iluzion dhe e shohin Vuçiqin ashtu siç është.

Edhe një pyetje të fundit, Kurti ka thënë se është urgjente të rregullohen marrëdhëniet me Serbinë përpara zgjedhjeve në ShBA më 2024. Pse do të kishte rëndësi kjo?

**Edward Joseph:** Ai nuk është i vetmi që është në dijeni të faktit se vitin e ardhshëm do të ketë zgjedhje presidenciale në ShBA. Vitin e ardhshëm janë edhe zgjedhjet për Parlamentin Evropian. Zgjedhjet do të jenë një shpërqendrim i madh për ShBA-në dhe do ta bëjë atë më pak të prirë për të marrë iniciativa ose për të ofruar vëmendje të nivelit të lartë në këto çështje. Shumë e thonë këtë, jo vetëm Kurti. Pra, ka njëfarë presioni kohor. Dhe kjo, në fakt, mund të jetë një gjë e mirë, sepse mund t'i përqendrojë përpjekjet dhe mund t'i bëjë ShBA-në dhe BE-në të jenë më serioze.



## Rama: Kemi shkëputur tri kontrata me kompani të papërgjegjshme

PRISHTINË, 12 SHTATOR - Kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, ka njoftuar se kanë shkëputur tri kontrata me kompani që, sipas tij, kanë qenë të papërgjegjshëm dhe nuk kanë respektuar kushtet e kontratës.

Rama ka thënë se këtyre kompanive do t'ua konfiskojnë vlerën e 10 për qind të projektit. "Ditët e fundit kemi shkëputur tri

kontrata me kompani të papërgjegjshme të cilat nuk kanë respektuar kushtet e kontratave të nënshkruara. Kompanitë në fjalë nuk kanë dëshmuar profesionalizëm dhe seriozitet në zbatimin e planit dinamik. Rrjedhimisht, kanë pasur ngecje të mëdha në realizim të punimeve duke mbajtur projektet e papërfunduara dhe duke vështirësuar jetën e qytetarëve

në lokacionet përkatëse. Nuk do të tolerojmë papërgjegjësi dhe joseriozitet në projektet e kryeqytetit. Kompanitë tilla do t'ua konfiskojmë sigurimin e ekzekutimit të punimeve që arrin vlerën 10 për qind të shumës së projektit. Do të vazhdojmë të sigurojmë cilësi e standard të ri të ndërtimit në rrugëtimin tonë të transformimit të kryeqytetit", ka njoftuar Rama.



## Gjykata anuloi vendimin për zgjedhjen e pesë anëtarëve të Këshillit Drejtues të UP-së, studentët kërkojnë zgjedhje të reja



PRISHTINË, 12 SHTATOR - Unioni Demokratik Studentor ka mbajtur konferencë për medie pas shpalljes së vendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë ndaj padisë së tyre në rastin e votimit të anëtarëve të rinj të Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina".

Festim Tasholli, sekretar i përgjithshëm i Unionit Demokratik Studentor, ka thënë se veprimet në UP janë udhëhequr nga "grupe kriminale të interesit që për qëllim e kanë kapjen e universitetit" dhe se vendimi i gjykatës ka vërtetuar se

"Universiteti i Prishtinës ka udhëheqje joadekuate që qëllim parësor ka interesat e ngushta grupore dhe jo zhvillimin e UP-së".

Ai ka kërkuar anulimin e të gjitha vendimeve të marra nga udhëheqja e universitetit dhe që menaxhmenti i UP-së të japë dorëheqje për t'u hapur rrugë zgjedhjeve të përgjithshme në "Hasan Prishtina". "Kemi pranuar aktgjykimin nga Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, ku aprovohet e bazuar padia jonë ndaj Universitetit të Prishtinës 'Hasan Prishtina' në rastin e

votimit të anëtarëve të rinj të Këshillit Drejtues. Me datë 24.06.2022 në mënyrë të kundërligjshme dhe me forca policore, studentët senatorë janë privuar nga e drejta e votës për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Drejtues, duke u larguar dhunshëm nga ndërtesa e Rektoratit të UP-së. Të gjitha këto veprime në UP janë udhëhequr nga grupe të interesit (kriminale) të cilat për qëllim kanë kapjen e Universitetit. Tashmë është vërtetuar edhe praktikisht që Universiteti i Prishtinës ka udhëheqje joadekuate që qëllim parësor ka interesat e

ngushta grupore dhe jo zhvillimin e UP-së", ka thënë Tasholli, duke kërkuar reflektim nga UP-ja.

"U bëjmë thirrje të gjitha instancave përgjegjëse të UP-së që të reflektojnë tani kur pretendimet tona janë të vërtetuara edhe me vendim nga institucionet e drejtësisë. Pas këtij vendimi, Këshilli Drejtues i UP-së dhe menaxhmenti në tërësi më e pakta që duhet të bëjnë është dorëheqja që t'u hapet rrugë zgjedhjeve të përgjithshme në Universitetin e Prishtinës 'Hasan Prishtina'. Gjithashtu, kërkojmë anulimin e të gjitha vendimeve të marra

nga kjo udhëheqësi e jashtëligjshme, duke përfshirë zgjedhjen e rektorit, sekretarit të përgjithshëm dhe Statutin e ri të miratuar", ka thënë ai.

Gjykata Themelore në Prishtinë e ka vlerësuar të mangët dhe se "nuk i përmban elementet e nevojshme mbi bazën e të cilave do të duhej të ndërtohej arsyetimi", argumentin e Senatit të UP-së për vendimin për zgjedhjen e anëtarëve të rinj të Këshillit Drejtues. Themeloria ka kërkuar, ndër të tjera, "riprocedurë dhe rivendosje" dhe kujdes nga Senati i UP-së gjatë hartimit të vendimit të ri.

## Komuna e Prizrenit largon pengesa të ndryshme të vendosura pa leje

PRIZREN, 12 SHTATOR - Komuna e Prizrenit ka bërë me dije se ka vazhduar largimin e pengesave, mallrave dhe reklamave të vendosura pa leje në hapësirat publike të qytetit. Kjo komunë ka njoftuar se

aksione të tilla do të vazhdojnë edhe në zona tjera të Prizrenit. "Sektori komunal për largimin e pengesave, mallrave të ndryshme dhe reklamave të vendosura pa leje në hapësira publike nga qytetarët e pronarët e

bizneseve. Aksioni është zhvilluar në rrugët 'Edit Durham', 'Rrustë Kabashi', 'Flamuri', 'Ahmet Prishtina', etj., ndërsa do të vazhdojë edhe në zona të tjera të qytetit", ka njoftuar komuna e Prizrenit.





## Dreshaj i AAK-së kritikon qeverinë: Jemi shteti i vetëm në rajon dhe Evropë pa sigurime shëndetësore

Prishtinë, 12 shtator - Grupi parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) ka mbajtur të martën një konferencë për media lidhur me problemet në sektorin e shëndetësisë. Deputeti nga radhët e AAK-së, Shemsedin Dreshaj, ka theksuar

se Kosova është shteti i vetëm në rajon i cili nuk ka sigurime shëndetësore. "Përkundër buxhetit të dyfishuar, vazhdon një situatë e ngjashme me probleme të njëjta dhe skandale të njëpasnjëshme. Premtimet e dhëna më herët ende vazhdojnë të ngelin premtime. Nuk kemi

asnjë veprim konkret. Vazhdon ikja e personelit (shëndetësor). Problemi me listën e barnave esenciale vazhdon sidomos në listën e pritjes. Në Klinikën e Ortopedisë ka pacientë që presin deri në katër vjet", ka thënë Dreshaj. Sipas tij, për të dalë nga kjo

situatë nevojitet që shëndetësia të bëhet prioritet kombëtar. Në fund, ai ka folur edhe për dialogun Kosovë - Serbi dhe çështjen e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Dreshaj ka thënë se palët nuk kanë vullnet politik për zbatimin e Asociacionit.



## Albin Kurti "përzihet" edhe në zgjedhjet e Zvicrës

PRISHTINË, 12 SHTATOR - Bashkëpunimi i kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, me Partinë Socialdemokrate të Cedric Wermuth, nuk është duke u pëlqyer në Zvicër. Një panel diskutimi i organizuar nga Partia Socialdemokrate e Zvicrës, në të cilin pritet të marrë pjesë kryeministri Albin Kurti gjatë shtatorit, ka nxitur reagime atje, meqë në Zvicër do të mbahen zgjedhjet në tetor. Në një artikull të publikuar nga "20min.ch", përmendet njohja e gjatë e Kurtit me Cedric Wermuth që nga vitet 2000 dhe bashkëpunimi që kanë pasur gjatë vitit 2019, kur Cedric Wermuth dhe Kurti kishin marrë pjesë në një kampanjë zgjedhore në Arau, dy vjet më vonë Partia Socialdemokrate e Zvicrës kishte bërë thirrje që të votohej Vetëvendosja.

"Në vitin 2023 Vetëvendosja dhe Partia Socialdemokrate kanë nënshkruar një marrëveshje me synim bashkëpunimi", shkruan "20min.ch". Pjesëmarrja e Kurtit në këtë panel

diskutimi me kandidatët që kanë lidhje kosovare dhe me Cedric Wermuth është thënë se ka për synim "kosovarët me pasaportë zvicerane", ka thënë një zëdhënës i Partisë Socialdemokrate.

Nga Partia Popullore e Zvicrës janë duke e konsideruar diçka të tillë si "plotësisht të gabuar". Përparim Avdili, një shqiptar nga një fshat i Maqedonisë së Veriut, ka thënë se "fakti që Kurti po bën fushatë për Partinë Socialdemokrate në rolin e një partie të krahut të majtë është shokuese". Avdili ka thënë se kosovarët që jetojnë në Zvicër mund t'i marrin vendimet për zgjedhjet në Zvicër edhe pa "i thënë një politikan kosovar se për kë të votojnë".

Sekretari i përgjithshëm i Partisë Popullore zvicerane dhe këshilltari kombëtar Peter Keller e ka përshkruar paraqitjen e planifikuar të Kurtit si "plotësisht të gabuar". "Zvicra nuk duhet të ndërhyjë në fushatat zgjedhore të huaja dhe vendet e huaja nuk duhet të ndërhyjnë në fushatën zgjedhore zvicerane", thekson



Keller.

Keller dhe Avdili kanë thënë se shohin paralele në mes të Kurtit dhe Erdoganit sa i përket "interferimit në fushatë zgjedhore". Por, Avdili ka theksuar se s'dëshiron ta barazojë Kurtin me Erdoganin. Ndërkohë për këtë është kundërpërgjigjur Cedric

Wermuth, duke thënë se ka dallim të madh në mes të Erdoganit dhe Kurtit. Dallimi me Erdoganin është se Kurti është "një fener demokracie në një rajon ku autokratët janë në rritje", ka shpjeguar bashkëpresidenti i PS-së, Cedric Wermuth. Sipas Wermuthit, "paraqitja e Kurtit

nuk është patronizuese edhe ndaj zviceranëve me rrënjë në Kosovë". "Sigurisht, këta njerëz marrin vendimet e tyre dhe nuk kanë nevojë që dikush t'u tregojë se si të votojnë" ka thënë Wermuth. Një veprim i tillë i Kurtit është kritikuar edhe në Kosovë nga opozita dhe shoqëria civile.

## Mbi 100 gjoba për tetë muaj, barnatoret me produkte të jashtëligjshme dhe pa farmacistë



PRISHTINË, 12 SHTATOR - Inspektorati Farmaceutik gjatë periudhës janar-gusht të këtij viti ka realizuar 635 inspektime, ndërsa ka gjobitur 114 subjekte. Në vazhdim e aksioneve kontrolluese janë gjobitur 54 subjekte që posedonin produkte të jashtëligjshme, ndërsa 43 raste kur gjatë kontrollit ka rezultuar se në farmacitë e ndryshme mungon farmacisti, siç është përcaktuar me ligj.

Në njoftimin për medie të Ministrisë së Shëndetësisë është bërë me dije se gjatë kësaj

periudhe inspektorati ka ndërmarrë masa edhe ndaj katër institucioneve shëndetësore private të cilat nuk ishin të licencuara.

Ndaj të gjitha rastet të cilat e kanë cenuar shëndetin publik janë ndërmarrë masat sipas autorizimeve ligjore. Ditë më parë ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, gjatë vizitës në Inspektoratin Shëndetësor, bëri me dije se që nga muaji shtator inspektorëve do t'u paguhen shtesat në vlerë të 250 eurove.

Së shpejti do të shtohen edhe

kapacitetet inspektuese dhe pas përfundimit të procedurave rekrutuese, numri i inspektorëve shëndetësorë do të shkojë në 37 nga 12 sa janë tani.

"Me qëllim të mbrojtjes së shëndetit publik, ofrimit të shërbimeve shëndetësore cilësore dhe zbatimit të ligjit, ftojme qytetarët të bashkëpunojnë dhe të sinjalizojnë kur hasin në veprimtari të dyshimta të institucioneve shëndetësore", ka njoftuar Ministria e Shëndetësisë.

## Agjencia e Kosovës për forenzikë pranon pajisje të specializuara

Prishtinë, 12 shtator - Agjencia e Kosovës për Forenzikë ka pranuar një donacion të pajisjeve të specializuara nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Kosovë të cilat do të shërbejnë për avancimin e ekzaminimeve forenzike dhe balistike.

Kryeshefi i AFK-së, Blerim Olluri, ka thënë se këto pajisje do ta ndihmojnë institucionin që drejton për përmirësimin e shërbimeve të tyre. I kënaqur me këto pajisje është shprehur edhe zëvendësministri i Punëve të Brendshme, Blerim Gashani. "Kjo ndikon në konfiskimin e

armëve ilegale. Deri më sot agjencitë dhe institucionet kanë treguar dhe dëshmuar që jemi shumë seriozë. Analiza balistike është pjesë e rëndësishme për ta parandaluar krimin. Ne nga ministria shprehim gatishmërinë për ta bërë vendin tonë më të sigurt,

rajonin, Bashkimin Evropian dhe më gjerë", ka thënë Gashani.

Ndërsa përfaqësuesi i UNDP-së në Kosovë, Nuno Queiros, ka thënë se shpreson që këto pajisje ta ndihmojnë AFK-në për avancimin e ekzaminimeve forenzike dhe balistike.





## Më 19 shtator mbahet ankandi i tetë i letrave me vlerë për këtë vit

PRISHTINË, 12 SHTATOR - Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka njoftuar se më 19 shtator 2023 do të mbahet ankandi i tetë për vitin 2023. Në këtë ankand do të emetohen obligacione me

maturitet pesëvjeçar në shumën prej 25 milionë eurosh.

Investimi në obligacione është investim i sigurt, i garantuar me Ligjin për Borxhin Shtetëror dhe

Garancitë Shtetërore, ku interesi i përcaktuar nga tregu ju garantohet për të gjithë kohëzgjatjen (5 vjet) dhe është tërësisht i liruar nga tatimi. “Për detaje rreth pjesëmarrjes në ankande për

blerjen e letrave me vlerë, ju lutem kontaktoni ndonjërin nga Bankat Komeriale që operojnë në Republikën e Kosovës”, ka njoftuar Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.



## Themelohet Lidhja e Bizneseve të Kosovës

PRISHTINË, 12 SHTATOR - Është themeluar Lidhja e Bizneseve të Kosovës e cila në njoftimin e saj ka theksuar se bizneset në Kosovë tani do të kenë mbrojtje dhe përkrahje për një klimë më të përshtatshme të të bërit biznes.

Lidhja e Bizneseve e Kosovës ka thënë se ka për qëllim t'i adresojë të gjitha nevojat e domosdoshme ligjore e teknike të bizneseve pranë institucioneve përkatëse. “Ne ofrojmë mundësi ekskluzive të rrjetëzimit. Ne krijojmë mundësi komunikimi mes bizneseve kosovare me bizneset vendore, rajonale, diasporës dhe shteteve të BE, ShBA-së me gjerë. Me ekspertët më të mirë, e me ekipin profesional që i ka brenda saj, me përvojën e jashtëzakonshme të biznesmenëve e afaristëve dhe të tjerëve që do të na

bashkëngjiten do të kontribuojmë për një klimë më të favorshme në aktivitete të bizneseve, duke i ndihmuar atyre t'i zgjerojnë operacionet, të rrisin prodhimin dhe të eksportojnë jashtë kufijve të vendit. Misioni qenësor i Lidhjes do të jetë: krijimi i një fryme për partneritete ekonomike vendore dhe partneritete ndërkombëtare me besim të plotë se do të përmirësohet ambienti i të bërit biznes në Kosovë, të mbështesë dhe promovojë biznesin e afarizmin vendor dhe ndërkombëtar, të promovojë prodhimin vendor për eksport dhe të ndihmojë e këshillojë bizneset e reja ('start up') si dhe të mbrojë këto biznese me të gjitha rrugët e mundshme mbi krijimin e partneriteteve me beneficione të ndërsjella



ndërmjet akterëve të ndryshëm në biznes, të sjellim bashkë-përfaqësues të ndryshëm të komunitetit të biznesit për të shkëmbyer njohuri dhe përvoja, si dhe

për të ndarë strategjitë dhe inovacionet e suksesshme në fushën e biznesit”, ka njoftuar Lidhja e Bizneseve të Kosovës.

Lidhja e Bizneseve të Kosovës ka njoftuar se do të kontribuojë edhe në rritjen dhe zhvillimin e ekonomisë lokale dhe të sektorit privat në përgjithësi. “Deri më tani pjesë e anëtarësimit në Lidhjen e Bizneseve janë mbi 150 kompani të profileve të ndryshme prodhuese, tregtare, shërbyese, financiare dhe të tjera. Po ashtu edhe disa shoqata të sektorëve të ndryshme. Udhëheqja e Lidhjes paralajmëron se në ditët në vijim do t'iu njoftojë përmes konferencave të saj për media, për programin dhe organet udhëheqëse në kuadër të Lidhjes së Bizneseve të Kosovës”, është thënë në njoftim.

## Kompania britanike 'Toka Management' vjen edhe në Kosovë, do t'i trajnojë të rinjtë për infrastrukturën e hekurudhave



PRISHTINË, 12 SHTATOR - “Toka Management”, kompani britanike që punon në mirëmbajtjen e hekurudhave në Londër, ka ardhur edhe në Kosovë përmes Qendrës së Trajnimit Hekurudhor. Gjatë ceremonisë së hapjes së kësaj kompanie është thënë se parimet themelore të funksionit të një hekurudhe janë të sigurojë një rrjet transporti cilësor që nxit tregtinë dhe sjell mallra në jetën e përditshme që, fatkeqësisht, nuk është rasti me hekurudhat në Ballkanin Perëndimor. Prandaj, qëllimi kryesor i qendrës do të jetë trajnimi dhe aftësimi i

të rinjve në infrastrukturën e hekurudhave dhe menaxhimin e tyre.

Zëvendës ambasadori britanik Paul O'Connor është shprehur i lumtur që vendi i tij, vendi i parë që ka zhvilluar hekurudhat në botë, do ta ndajë përvojën shumëvjeçare me Kosovën. Siç është shprehur ai në hapjen e “Toka Management”, hekurudhat kanë luajtur rol kyç në ekonominë e Britanisë së Madhe dhe tani do ta ndihmojnë edhe ekonominë e Kosovës, duke e lidhur përmes një hekurudhe Prishtinën me portin e Durrësit.

## Mbi 16 mijë familje kanë aplikuar për subvencionimin e faturave të energjisë

PRISHTINË, 12 SHTATOR - Ministri i Financave, Hekuran Murati, ka njoftuar se deri më tani kanë aplikuar mbi 16 mijë familja për subvencionimin e faturave të energjisë elektrike. Murati ka treguar se aplikimi

do të jetë i hapur deri në fund të muajit shtator. “Mbi 16 mijë familje kanë aplikuar deri më tani për subvencionim të faturave të energjisë elektrike. Aplikimi do të jetë i hapur deri në fund të muajit shtator dhe

mund të bëhet online në formularin <https://see.rks-gov.net>. Inkurajohen të aplikojnë të gjitha familjet që kanë të ardhura mesatare mujore më pak se 150 euro për anëtar. Në veçanti, inku-

rajohen të aplikojnë familjet që kanë anëtarë me aftësi të kufizuara, që janë prindër vetëshqyes, apo që janë pensionistë që jetojnë vetëm e pa përkujdesje”, ka njoftuar Murati.





# Burrat 600 miliardë dollarësh



Shtrirja e ambicies së Arabisë Saudite në sportin global është aq e gjerë, sa që është marramendëse, por për të kuptuar se si funksionon, mund të shikoni historinë e një prej investimeve të para të vendit, në lojërat e mundjes profesionale.

Në vitin 2014, Arabia Saudite solli WWE në Riad. E mbajtur në stadiumin Green Halls dhe e faturuar si një "aktivitet live", debutimi nuk u transmetua në televizion dhe ai ishte një imitim i garave të mundjes të organizuara më parë në Emiratet e Bashkuara Arabe. Luftëtarë të tillë si Roman Reigns, Dolph Ziggler dhe John Cena konkurruan gjashtë ndeshje përpara një turme meshkujsh në deliri.

"Të gjithë janë me të vërtetë krenarë që kemi vizituar qytetin e tyre," tha Cena, duke pozuar për selfie me personalitete të veshura me rroba tradicionale. Në një pankartë në turmë shkruhej: "E kam pritur këtë WWE gjithë jetën!"

Katër vjet më vonë, WWE ra dakord për një "partneritet strategjik" 10-vjeçar me ministrinë saudite të sportit. Në vend të vetëm netëve gjenerike, Riadi do të kishte një aktivitet me porosi, Crown Jewel, logoja e tij jeshile smeraldi i flamurit saudit. Sipas faqes së internetit Wrestlenomics, WWE fitoi 50

milionë dollarë për shfaqje.

Në SHBA, pasoi një reagim i ashpër. Ligji saudit i ndalonte mundëset femra të merrnin pjesë në eventin e parë, duke provokuar kritika që u kundërshtuan nga drejtuesit e mundjes. "Nuk mund t'i diktosh një vendi apo feje se si i trajtojnë gjërat," tha ekzekutivi i WWE Triple H. Më shumë protesta pasuan vrasjen e gazetarit Jamal Khashoggi në vitin 2018. Cena u tërhoq nga aktiviteti i Riadit atë vit dhe nuk është rikthyer më. Undertaker u prit me fërshtëllima në SHBA thjesht sepse tha "Crown Jewel".

Sidoqoftë, në vitin 2019, WWE zgjeroi marrëveshjen e vet me Arabinë Saudite. Disa nga ngjarjet më fitimprurëse të ndeshjeve me pagesë për shikim u sollën në mbretëri. Lista e interpretuesve u zgjerua, duke përfshirë Tyson Fury – i cili luftoi në Crown Jewel – dhe mundësin e famshëm Logan Paul. Mundësit kryen aktivitete komunikimi në Riad, duke diskutuar parandalimin e ngacmimeve me fëmijët e një shkolle, të diplomuarit e së cilës përfshijnë ministrin saudit të sportit. Në fund u mbajt edhe një ndeshje mes mundëseve femra; WWE e përshëndeti ngjarjen si një shënues përparimi.

Megjithatë, pati disa incidente të pazakonta. Në vitin 2019,

një aeroplan me 175 mundës dhe staf të WWE në mënyrë misterioze, nuk ishte në gjendje të largohej nga Riadi. WWE fajësoi një problem mekanik për vonesën prej gjashtë orësh, por dosjet ligjore, të paraqitura gjatë një padie në grup në lidhje me marrëdhëniet financiare të WWE me Arabinë Saudite, sugjeruan se avioni ishte mbajtur nga autoritetet saudite, për shkak të një mosmarrëveshjeje mbi pagesën e tarifave. Në vitin 2022, një konferencë për shtyp e Crown Jewel u ndërpre nga një grup burrash që brohorisnin: "MBS! MBS!" – akronimi me të cilin njihet princi i kurorës dhe lideri de fakto i Arabisë Saudite, Mohammed bin Salman. Këtë vit, burimet e WWE u detyruan të mohonin raportet se kompania kishte qenë subjekt i një oferte shumë miliarda dollarëshe për blerje nga Fondi i Investimeve Publike të Arabisë Saudite (PIF).

Dave Meltzer është redaktori dhe botuesi i buletinit me ndikim të Wrestling Observer dhe një kritik i hershëm i marrëdhënieve të WWE me Arabinë Saudite. "Ishin shumë para për dy shfaqje në vit," thotë ai për marrëveshjen. "Në këmbim, WWE ndihmoi në promovimin e Arabisë Saudite në transmetimet e saj, jo vetëm në vetë aktivitetet, por

në të gjitha shfaqjet e saj televizive. Pas vrasjes së Khashoggi, ata e ulën disi aktivitetin për disa shfaqje. Tani është kthyer në promovim shumë të fortë, që flet se sa i mrekullueshëm është vendi, sa progresiv po bëhet. Unë nuk mendoj se njerëzit presin standarde të larta morale nga mundja profesionale. [Por] me kalimin e kohës... çdo negativitet, është zhdukur."

Ndërsa Arabia Saudite po rrit me shpejtësi portofolin e saj sportiv, detajet do të ndryshojnë, por disa tema mbeten të pandryshueshme: angazhimi i ndjekur nga investimet, përçarja e shoqëruar nga polemika dhe, në fund të të gjithave, rritja e ndikimit saudit. Në vend të mundjes, mund të vendosni golfin apo futbollin. Ose tennisin, ose kriketin, ose boksën, ose sportet motorike, garat me kuaj ose sportet luftarake, sportet ujore ose sportet e plazhit, ose sportet urbane, apo edhe sportet dimërore, dhe gjithashtu shahun.

Ambiciet sportive të Arabisë Saudite këtë vit janë tejkuluar. Sezoni Saudit i Pro League filloi më 11 gusht: Karim Benzema, Jordan Henderson etj. Departamenti Amerikan i Drejtësisë mund të jetë duke drejtuar një hetim anti-trust për mega-bashkimin e

propozuar të golfit, por LIV Golf i financuar nga PIF vazhdon. Në shtator, Kampionati Botëror i Peshëngritjes vjen në Riad, i ndjekur nga në tetor nga Lojërat e ringjallura Botërore të Luftimit dhe një fazë e Turit të Kampionëve Globalë në hipizëm.

Fury do të luftojë në qytet, në një garë jozyrtare kundër Francis Ngannou, nga Ultimate Fighting Championship. Në nëntor, qyteti lindor i Dammamit do të presë ekuivalentin e hendbollit të Kupës së Botës për Klube, Super Globe. Në dhjetor, Kupa Botërore e Klubeve aktuale e FIFA-s vjen në Xhedah, në të njëjtën kohë që qyteti do të presë evenimentin e parë të tenisit ATP të Arabisë Saudite, Next Gen Finals.

Ndërkohë në malet e veriperëndimit vijon puna për ndërtimin e rajonit të Trojenës. Ai do të jetë vendi për Lojërat Dimërore Aziatike 2029, një aktivitet që Arabia Saudite e shpëtoi nga zhdukja e mundshme. Trojena është një nga katër rajonet që do të formojnë projektin gjigant të Neom dhe karakteristikat e tij të planifikuara përfshijnë "një fshat të palosshëm" rezidencash luksoze dhe një rrjet prej 36 km pistash të skive. Pistat do të ndërtohen në një mal, Jabal al-Lawz, të cilin literatura e përshkruan si



“mesatarisht më të freskët se pjesa tjetër e mbretërisë”. Megjithatë, me një minimum mesatar dimëror prej 3 gradë Celsius, një ekip “teknikësh të prodhimit të borës” janë punësuar për të bërë realitet një ëndërr të brishtë.

Krahasuar me Trojenan, një aktivitet testimi në Rotterdam muajin e ardhshëm për Serinë E1 duket relativisht këmbësor. Kampionati i parë në botë i motobarkave elektrike, E1 kërkon të rrokë magjepsjen e garave me motor në ujë, në “qytetet ikonë anembanë botës”. Ishte duke përjetuar një pezullim të gjatë deri vitin e kaluar, kur PIF zuri një vend në bord. Tani, gara e parë zyrtare është vendosur për në Jeddah në “fillim të 2024”. Pritet që E1 të jetë pjesë e një përpjekjeje për ta bërë Arabinë Saudite një destinacion për klasën e jahteve. Guvernatori i PIF, Yasir al-Rumayyan, tha se përfshirja e fondit do të “ndihmonte gjithashtu në zhvillimin e teknologjisë inovative të qëndrueshme, e cila nga ana tjetër i pozicionon Sauditet si një mundësi në industrinë e së ardhmes”.

Rumayyan është 53 vjeç, ai u arsimua në Arabinë Saudite dhe bëri emër duke punuar në sektorin bankar të vendit. Në vitin 2015, u thirr për një takim me Princin Mohammed, ku iu kërkua të drejtonte fondin e pasurisë sovraane të vendit, i cili ka rreth 600 miliardë dollarë asete nën menaxhim. “Nuk e njihja fare”, tha Rumayyan në një intervistë me Bloomberg. “Mendova se do të

ishite një intervistë, por ishte pak a shumë: “Ja çfarë dua të bësh.”

Doli se shumë nga ato që Princi Mohammed donte që Rumayyan të bënte përfshinin sportin. PIF ka qenë një mjet për shumë nga investimet që Arabia Saudite ka bërë në këtë sektor dhe Rumayyan shpesh i ka drejtuar ato. Ai është presidenti i Newcastle United, mban fjalime për fundin e sezonit për tifozët dhe udhëhoqi delegacionin e klubit në finalen e Carabao Cup në Wembley. Ai do të bëhet kryetar i grupit që përbëhet nga PGA Tour, DP World Tour dhe LIV. Ai është fytyra e ambicieve sportive të Arabisë Saudite dhe, si me motobarkat elektrike, deklaratat e tij publike priren të hedhin pak dritë mbi qëllimet e vendit.

Jo se kjo dritë është verbuese. Gjatë seancave dëgjimore të fundit në Senatin e SHBA-së për aktivitetet në të cilat LIV u shndërrua nga një konkurrent kryengritës në aktor aktual në fushën e golfit, komiteti për sigurinë dhe çështjet qeveritare bëri vëzhgimin e mëposhtëm: “Ndërsa rritja e fundit e PIF përfshin investime të konsiderueshme në Shtetet e Bashkuara, shtrirja e saktë e këtyre investimeve dhe nëse ato luajnë një rol në ndonjë fushatë më të madhe të ndikimit të Arabisë Saudite mbetet kryesisht e panjohur. (Kur u ftua për të dhënë dëshmi para komitetit të Senatit, Rumayyan bëri bisht duke përmendur “përplasje

agjende”).

Nga 64 fonde sovraane të pasurisë, PIF u rendit i 56-ti për transparencë nga Instituti Peterson për Ekonominë Ndërkombëtare në Uashington në vitin 2021 dhe është e pamundur të kihet një pamje e plotë e zotërimeve të tij. As nuk është mjeti i vetëm financues i Arabisë Saudite. Këtë muaj, PIF njoftoi se do të kanalizonte aktivitetin sportiv përmes një kompanie të re, SRJ Sporting Investments, e cila do të “investonte në blerjen dhe krijimin e aktiviteteve të reja sportive IP [pronësi intelektuale], të drejta komerciale të garave sportive të njohura dhe të spikatura dhe organizimin e eventeve të mëdha sportive në Arabinë Saudite”.

Një tjetër nënndarje e PIF, Sanabil, është e specializuar në investimet në kapitalin sipërmarrës dhe fondet e kapitalit privat. Përsëri Rumayyan është kryetar, dhe Sanabil mban aksione në biznese që nga ana e tyre kanë interesa sportive: CVC Partners dhe Silver Lake, për shembull, dy fonde ku Sanabil është i përfshirë, ka aksione respektivisht në La Liga dhe Manchester City.

Pastaj është Aramco, kompania shtetërore e naftës që raportoi të ardhura prej 535 miliardë dollarësh në vitin 2022. Vitin e kaluar, Aramco njoftoi një partneritet me Këshillin Ndërkombëtar të Kriketit për t’u bërë sponsor titulli i çdo aktiviteti të ICC, duke përfshirë Kupën Botërore

të Kriketit të Tetorit. Është gjithashtu sponsori titullar i një turneu të ri të golfit për femra. Është një partner global i Formula 1, ka ndërmjetësuar një partneritet me Shoqatën Kineze të Basketbollit dhe financon kampionatin 10 milionë Gamers Without Borders. Mund ta merrni me mend emrin e shefit të Aramco.

Çdo cep i shtetit saudit, me sa duket, po shkon drejt sportit. Edhe Neom, i cili do të “ndryshojë fytyrën e të jetuarit në këtë planet” (por ende nuk është ndërtuar), ka 400 milion dollarë në marketing për të investuar në McLaren.

Kjo është një strategji sportive që është po aq gjithëpërfshirëse dhe më e detajuar se çdo strategji tjetër në botë”, thotë një drejtues i cili ka qenë palë në planifikim, duke folur në kushte anonimiteti. “Nuk është një modë, nuk është vetëm teka e ndonjë pasaniku. Kjo është planifikuar, është një qasje reale ndaj asaj që sporti mund të bëjë për të ndryshuar një komb në lidhje me shëndetin, mirëqenien dhe pjesëmarrjen aktive. Është një plan vërtet i detajuar dhe është bazuar në strategjitë më të mira sportive në botë. Kjo është një qasje shumë e koordinuar.”

Ndonjëherë mund të duket se ka po aq strategji sa ka mundësi investimi. Dokumenti themelues është Vizioni 2030. I publikuar në vitin 2016, ai është një shpallje misioni që tregon një rrugë drejt “një Arabie Saudite të

fortë, të lulëzuar dhe të qëndrueshme që ofron mundësi për të gjithë”, sipas princit Mohammed, në parathënie. Vizioni 2030 ka tre shtylla, njëra prej të cilave kërkon të heqë varësinë e të ardhurave të mbretërisë nga të ardhurat e naftës. Nënshpyllat janë 13 programe “realizimi”, një prej të cilave është cilësia e jetës. Nga 10 objektivat e këtij programi, dy të parat janë “promovimi i aktiviteteve sportive në komunitet” dhe “arritja e përsosmërisë në disa sporte në nivel rajonal dhe ndërkombëtar”.

Ekziston një strategji e veçantë për promovimin e sportit në komunitete. Ka objektiva kombëtare për lëvizjen e popullsisë – 20% e të cilëve klasifikohen si obezë. Në paratë e drejtuar për futbollin, dallohet një lidhje me shëndetin publik. Ka pasur një shpërthim në akademitë e futbollit dhe programet e stërvitjes. Pas krijimit të një departamenti të futbollit për femra në Federatën e Futbollit të Arabisë Saudite në vitin 2019, deri në 50,000 vajza mendohet të luajnë në një ligë shkollore.

Futbolli është deri tani sporti më popullor i Arabisë Saudite dhe zakonisht hidhet argumenti se duke parë yjet e sapo importuar në Pro League, fëmijët do të frymëzohen për aktivitete. Sipas atyre brenda qiellit të futbollit saudit, ardhjet e futbollistëve të huaj do të ndihmojnë gjithashtu talentin profesionist vendas. Ka objektiva jo vetëm për ta







bërë Ligën saudite një nga 10 garat më të mira në botë, por edhe për ta futur kombëtaren e meshkujve në top 10-shen e FIFA-s (nga vendi i 54-të). Duket e çuditshme, por Arabia Saudite ka një histori të gjatë në futbollin e meshkujve, është një nga kombet më të suksesshme në Azi dhe ka një bazë tifozësh për futbollin e klubeve dhe atë ndërkombëtar, që mund të rivalizojë shumë vende në Evropë.

Ka strategji për sporte të tjera, që mendohet se janë deri në 16 gjithsej. Disa nga këto janë aktivitete më pak të njohura globalisht që mund të ofrojnë një rrugë afatshkurtër drejt suksesit në Lojërat Olimpikë. Një interes në rritje për sportet e plazhit, duke përfshirë futbollin në plazh, dhe në lojërat urbane si basketbolli 3x3, shpjegohet me këtë qasje. Po kështu, edhe angazhimi me sportet luftarake, duke përfshirë formimin e një grupi të përbashkët saudit-japonez për Vizion 2030, si pjesë e të cilit Japonia dërgoi katër kampionë të karatesë në Gjirin Persik.

Arabia Saudite është një monarki me trashëgimi dhe linja Saudite ka sunduar për një shekull duke balancuar prioritetet e palëve të ndryshme të interesit. Në një komb ku 67% e popullsisë janë nën 35 vjeç, një strategji në të cilën sporti ofron argëtim, stimul dhe krenari kombëtare mund të jetë me shumë kosto efektivitet. Zhvillimi i

brendshëm nëpërmjet sportit është diçka që zyrtarët duan të theksojnë. Nuk është fokusi i vetëm.

Shprehja “sportswashing – shpëlarje përmes sportit” përshkruan praktikën e kombeve (ose individëve dhe bizneseve) që rehabilitojnë reputacionin e keq përmes sportit. Amnesty International ka pohuar vazhdimisht se investimet sportive të Arabisë Saudite janë të përdorura për të fshehur “shtypjen në rritje” të princit Mohammed. Ai citon dënimin penal të të paktën 15 individëve vitin e kaluar për çështje të “shprehjes paqësore ose shoqërimit”. Në të njëjtin vit, ligji i statusit personal kodifikoi disa aspekte të sistemit të kujdestarisë saudite që kufizojnë liritë e grave. Ndërkohë, Salma al-Shehab, një studente e Universitetit të Leeds, mbetet në burg në Arabinë Saudite duke vuajtur një dënim 27-vjeçar pasi u shpall fajtorë për vepra terrorizmi kur bëri postime në Twitter në mbështetje të të drejtave të grave.

Sipas Joseph Nye, një akademik i Harvardit dhe ish-zyrtar në administratën e Klintonit, përdorimi i sportit për të shkëputur vëmendjen nga shkeljet e të drejtave të njeriut mund të jetë efektiv. “Nëse je saudit, duke u përpjekur të tërheqësh vëmendjen nga vrasja e Khashoggit, atëherë... një turne i ri golfi mund të ndihmojë”, thotë ai. Por sporti mund të arrijë qëllime të tjera

politike. Nye shpiku termin “fuqi e butë”, të cilën ai e përshkruan si “aftësia për të marrë atë që dëshiron përmes joshjes dhe jo përmes imponimit ose pagesës”. Sporti, thotë Nye, është një mjet efektiv me fuqi të butë sepse “shpesh krijon një mjedis të favorshëm dhe tërheq vëmendjen”. Mund të mos funksionojë gjithmonë, thotë ai – “mendoni për tifozët britanikë të futbollit në Evropë... por zakonisht funksionon”.

Përdorimi i sportit më pak si shpërqendrim dhe më shumë si një formë bindjeje është ajo që shumë njerëz që i kanë sytë nga projekti sportiv saudit, besojnë se është forca e tij lëvizëse.

“Sporti, me komponentin masiv emocional të lidhur me të dhe mbulimin e gjerë mediatik, mund të përftojë investime në sektorë të tjerë të ekonomisë,” thotë Andrea Sartori, CEO i Ace Advisory dhe një konsulent sportiv, i cili, ndër të tjera, ndihmoi në zhvillimin e strategjisë sportive të Katarit. “Për mendimin tim, është një mundësi që Arabia Saudite, me një kosto relativisht të ulët, të ripozicionohet shpejt në tregun ndërkombëtar. Ata po përpiqen të shtyjnë zhvillimin e industrisë së turizmit, një industri nga e cila mund të diversifikohen relativisht kollaj, ose të përshtaten me industrinë e reja, larg naftës dhe gazit.

“Nuk duhet të shikoni vetëm

shumat e parave të investuara, por duhet të shikoni shpejtësinë me të cilën ndryshojnë opinionet e njerëzve”, thotë Sartori. “Në katër apo pesë vitet e ardhshme, ata do të ndryshojnë mentalitetin dhe perceptimin tonë për vendin – diçka tjetër do të arrihet në një dekadë”.

Hulumtimi nga The Guardian vlerësoi se sauditët kishin shpenzuar 6 miliardë dollarë në projekte të lidhura me sportin që nga fillimi i vitit 2021. Vitin e kaluar, PIF bëri një investim prej 30 miliardë dollarësh në degën e infrastrukturës së grupit të kapitalit privat Blackstone (Rumayyan shpalli marrëveshjen dhe kreu global i Blackstone është David Blitzer, bashkëpronar i Crystal Palace). Në fund, thotë Sartori: “Po, ata do të kenë shpenzuar ndoshta 20 miliardë dollarë, 30 miliardë dollarë. Por çfarë është kjo në buxhetin e mbretërisë së Arabisë Saudite? Asgjë. Është një buxhet marketingu.”

Me synimet e brendshme, ndërkombëtare dhe rajonale, strategjia sportive e mbretërisë mund të jetë transformuese. Është gjithashtu e mundur që ajo të vyshket nën peshën e ambicieve të saj, ose që ngjarjet ta pengojnë.

“Ka një rrezik,” thotë Sartori, “dhe ky është nëse çmimi i naftës ulet. Atëherë humori i kreut të shtetit mund të ndryshojë dhe strategjia mund të bëhet më pak agresive, më

konservatore... E pashë të ndodhte në Katar 10 vjet më parë.”

Terrence Burns është një konsulent sportiv i cili ka punuar në një numër ofertash të suksesshme olimpikë. Arabia Saudite, siç pritej, është lidhur me organizimin e Lojërave Olimpikë dhe Kupës së Botës, ndoshta që nga viti 2030.

“Vendet si Arabia Saudite nuk kishin mjetet apo aftësinë 20 vjet më parë për të investuar kaq shumë para në port”, thotë Burns. “Ata po ndërtonin ekonomitë e tyre. Tani kanë para dhe sporti është një investim i madh nëse bëhet siç duhet. Investimet në evente dhe liga bëjnë dy gjëra: tërheqin turizmin dhe krijojnë vende pune. Krahas kësaj vjen edhe infrastruktura tregtare që mbështet sportin, gjë që është e mirë për vendin”.

Një investim i tillë kërkon përforsim të vazhdueshëm, argumenton Burns. Dhe ashtu si paratë kanë rrjedhur në sport, po ashtu mund të ndalojnë së vepruari. “Për mua është shumë e thjeshtë: sapo këto investime të mos japin kthimin që pritet, ata do të ndalojnë së bëri ato,” thotë ai. “Kjo nuk është ndonjë strategji e mbrapshtë nga skutat e errëta të mendjes së njerëzve; është biznes. Në momentin që ata nuk marrin një kthim nga investimi, atëherë ai ndalon.” / The Guardian – Bota.al





**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



## TKZ: Ne nuk jemi thjesht tifozë, jemi pasardhësit e një historie të lavdishme

**TIRANË, 12 SHTATOR** - Në ndeshjen ndaj Polonisë edhe njëherë tjetër grupi "Tifozat Kuq e Zi" tregoi mbështetjen maksimale. Por edhe në Pragë ndaj Çekisë ata ishin të shumtë në numër dhe për 90 minuta nuk reshtën së brohorituri për kuqezinjtë.

Me anë të një postimi në rrjetet sociale, TKZ shkruan se ata nuk janë thjesht tifozë, por pasardhësit e një historie të lavdishme dhe një familje. "Me mijëra kilometra të përshkuara nga anëtarët brenda vetëm 4 ditësh tregojnë jo vetëm pasionin

dhe ndjenjën e thellë që kemi për tokën dhe kombin tonë, por edhe vullnetin e palëkundur për t'i bashkuar forcat për dashurinë e vetme, atë të Shqipërisë! Kur shohim mijëra shqiptarë nga çdo cep i botës që janë mbledhur me qëllimin e

vetëm për të përkrahur dhe ngritur lart flamurin tonë, kuptojmë se jemi një komb i bashkuar dhe i palëkundur. Ne nuk jemi thjesht tifozë, jemi pasardhësit e një historie të lavdishme dhe një familje! Ne jemi Tifozat e Kuq e Zi", thuhet në postimin e



tifogrupit më të madh në mbështetje të Kombëtares shqiptare.

## Kosova pëson humbje nga Rumania

**PRISHTINË, 12 GUSHT** - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll ka pësuar humbje nga Rumania (2-0). "Dardanët" janë munduar për të nxjerrë një rezultat pozitiv, por kjo ishte mjaftë e vështirë për faktin se komplet pjesën e dytë e luajti me një lojtar me pak. Ndeshja u ndërpre në minutën e 18-të për shkak të thirrjeve nacionaliste dhe banderolave të llojit "Kosova është Serbi". Fillimisht gjyqtari i dërgoi futbollistët në zhyshitore dhe me pas rifilloi ndeshja. "Dardanët" luajtën mirë në pjesën e mbetur të pjesës së parë dhe krijuan dy raste të arta shënimi, por Vedat Muriqi dhe Edon Zhegrova. Dy minuta pa përfunduar pjesa e parë, Kosova mbeti me një futbollist më pak në fushë pasi Vedat Muriqi u ndëshkua me kartonin e dytë të verdhë dhe

u përjashtua nga loja. Në pjesën e dytë "Dardanët" u rikthyen në mbrojtje për ta ruajtur rezultatit dhe në minutën e 59-të vendasit fituan një penallti. Megjithatë portieri i Kosovës, Arijanet Muriq priti penalltinë e kapitenit të vendasve Christian Stanciu. Në minutën e 83-të ndeshja u zhblokua, kur Stanciu realizoi për 1-0. Pavarësisht epërsinë numerike, Kosova krijoi edhe dy raste tjera që nuk i shfrytëzuan Loshaj dhe Muslija. Në fund të ndeshjes zëvendësuesi Mihala realizoi edhe golin e dytë për t'i dhënë tri pikët vendasve me rezultat 2-0. Gjasat e Kosovës për kualifikim zbehën pasi pas gjashtë ndeshjeve Kosova ka katër pikë në pozitën e katërt, derisa Grupin E e udhëheq Zvicra me 14 pikë dy më shumë se rumunët në pozitën e dytë.



### 'Dardanët' U21 pëson humbje nga Gjermania

Përfaqësuesja e Kosovës U21 ka zhvilluar ndeshjen e tretë në kuadër të kualifikimeve për "Euro 2025". "Dardanët" nuk arritën t'i rezistojnë favoritit të Grupit D, Gjermanisë, aty ku marrin pjesë edhe Polonia, Bullgaria, Estonia e Izraeli. Në stadiumin "Fadil Vokrri", Kosova bëri paraqitje të mirë, por ishte e pafat. Kosova përmbylli pjesën e parë 0-0. Në pjesën e dytë Gjermania me çdo kusht e kërkonte golin derisa në minutën 74, Youssoufa Moukoko e shënoi të parin. Katër minuta më vonë, mysafirët thelluan epërsinë dhe i njëjti futbollist shënoi golin e dytë. Gjermanët dominuan në vazhdimësi, derisa një minutë pas ndeshja të përfundoi, Colin Kleine Bekel shënoi për 3 me 0, çka ishte edhe rezultati përfundimtar.

## KOK-u: Vendimi i MKRS-së për pezullimin e Federatës së Karatesë ishte i ngutshëm

**PRISHTINË, 12 SHTATOR** - Federatës së Karatesë së Kosovës i është pezulluar licenca të hënën nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Sipas njoftimit të MKRS-së, ministri Hajrulla Çeku ka aprovuar propozimin e Komisionit Vlerësues për Licencimin e Federatave Sportive për pezullim të licencës të kësaj federate. Sipas vendimit, veprimet e Federatës së Karatesë janë në kundërshtim me Ligjin për Sport, Udhëzimin



Administrativ për kushtet, kriteret dhe procedurat e themelimit, licencimit dhe rivlerësimit të federatave, si dhe Statutin e FKK-së.

Komiteti Olimpik i Kosovës, në një përgjigje për "Klankosova.tv", e ka cilësuar të ngutshëm këtë vendim. "Mendojmë se pezullimi i licencës së Federatës së Karatesë së Kosovës, ka qenë pak i nxituar, sidomos për arsye se është bazuar në rekomandimin e komisionit për licencim, i cili ka theksuar se vetëm klubet e licencuara kanë të drejtë vote, gjë të cilën nuk mund ta përcaktojë ministria, por vetëm statuti i federatës dhe

aktet normative të brendshme, të cilat e definojnë anëtarësimin", thuhet në përgjigjen e KOK-it. Ky komitet tutje potencoi se është me rëndësi që të mbrohet autonomia e federatës dhe të mos dëmtohen sportistët e karatesë. "Duhet të jemi të kujdesshëm të ruajmë autonominë e federatave dhe vendimet e kuvendeve të tyre, si organe më të larta të federatës. Besoj se të gjitha palët do të

reflektojnë dhe do të gjejnë një zgjidhje të përbashkët në koordinim FKK, KOK, MKRS, që sportistët e karatesë mos të dëmtohen, dhe njëkohësisht të mbrojmë autonominë e Federatës, duke respektuar aktet normative të federatave sportive ndërkombëtare dhe kartën olimpikë. Gjithashtu, duhet të respektojmë edhe Udhëzimin Administrativ për Licencimin e Federatave, Ligjin për Sport dhe Ligjin e Asocimit të lirë".

## Luiza Gega thyen sërish rekordin kombëtar

**TIRANË, 12 SHTATOR** - Luiza Gega vijon shkëlqimin në garat e atletikës. Sportistja shqiptare ka vendosur një tjetër rekord të ri kombëtar, këtë herë në garën e 2 000 metrave me pengesa. Me kohën 5 minuta, 56 sekonda dhe 79 të qindtat, Gega e ka mbyllur e katërta garën në

turneun Botëror të Atletikës, mbajtur në Zagreb të Kroacisë, për kategorinë "Gold". Me kohën 5:56,79 sportistja kuqezi përmirëson për disa sekonda rekordin kombëtar në këtë disiplinë, të vendosur nga vetë ajo më 2019 me kohën 6:00.07.

Koha 5:56.79 e regjistruar nga Luiza Gega në Zagreb është koha e dytë me e mirë në historinë e disiplinës 2000 metra me pengesa në Evropë dhe e katërta më e mirë në botë. Pak javë më parë Luiza Gega përmirësoi një tjetër rekord të vetin, duke bërë që me kohën

9:09.64 ta thyente edhe rekordin kombëtar në garën e 3 000 metrave me pengesa, në turneun "Diamond League" që u zhvillua në Cyrih të Zvicrës. Kështu, Gega mbyll sezonin me dy rekorde të reja kombëtare, në garën e 2 000 dhe 3 000 metrave me pengesa.





## Asani: Kemi edhe tri finale për t'i luajtur

TIRANË, 12 SHTATOR - Jasir Asani ishte figura kryesore e fitores së madhe të Shqipërisë ndaj Polonisë me rezultat 2-0 duke siguruar tri pikë që e shndërruan në liderin e Grupit E me 10 pikë

pas pesë ndeshjeve. Asani është shprehur shumë i lumtur për golin e shënuar, por ka kërkuar vetëpërmbytje për të vazhduar drejt synimit për t'u kualifikuar në

Kampionatin Evropian që zhvillohet vitin e ardhshëm. "Jemi në vend të parë. Kemi edhe tri finale. Pa eufori, ëndrra jonë është vetëm një: finalja 'Gjermani 2024'. Këtë gol ia dedikoj familjes sime

dhe të gjithë shqiptarëve në të gjithë botën, kryesisht trajnerit Silvinho, i cili besoi tek unë. Faleminderit mister, faleminderit Shqipëri! Bashkë drejt 'Gjermani 2024'", ka shkruar Asani në "Facebook".



# 'Fortesa' e kuqezinjve, shifrat dhe statistikat e Shqipërisë në 'Air Albania'

TIRANË, 8 SHTATOR - "Air Albania" ishte dëshmitare e fitores më të madhe që kombëtarja kuqezi e futbollit ka shënuar në impiantin më modern të kryeqytetit. Një triumf 2-0 ndaj Polonisë së Lewandowskit, që zgjoi pasionin dhe entuziazmin e një kombi të tërë. Dhe që na vendos në një pozicion më të afërt se kurrë me kualifikimin e dytë historik në Evropian. Përtej fitores, festës dhe gëzimit që përshkroi të gjithë shqiptarët në mbrëmjen e 10 shtatorit, është koha për t'i rishikuar statistikat dhe rezultatet e Kombëtares në ndeshjet e zhvilluara në "Air Albania". Kuqezinjtë kanë luajtur 15 ndeshje qëkur impianti i parametrave dhe standardeve evropiane u inaugurua për sfidën e 17 nëntorit të 2019-s ndaj Francës. Dhe nga ai moment kemi marrë 6 fitore, 6 humbje dhe 3 barazime. Një ndikim të madh në këto shifra, sa iu takon fitoreve dhe humbjeve, kanë pasur ndeshjet e vitit të kaluar, ku Shqipëria luajti plot gjashtë herë në "Air Albania" dhe mori vetëm një fitore: ndaj Armenisë në një ndeshje miqësore. Stadiumi ku zhvillohen ndeshjet si pritës shndërrohet në lojtarin e 12 dhe në mbështetësin kryesor. Ku mjafton një shkëndijë nga tribunat për ta ndezur entuziazmin, "zjarrin" dhe dëshirën brenda lojtarëve. Dhe tri ndeshjet e fundit të luajtura në "Air Albania" janë një sugjerues i madh që kuqezinjtë mund dhe duhet të bazohen mbi këto



rezultate shpresëdhënëse, në mënyrë që stadiumin ta kthejnë në një armë plus. Në repertorin e madh të organikës së lojtarëve që kemi, me cilësi të padiskutueshme, duke nisur nga porta në sulm. Triumfi 2-0 ndaj Armenisë më 19

nëntor të vitit të kaluar, ai kundër Moldavisë, po 2-0 në qershorin e këtij viti, së fundmi sukcesi i fantastik 2-0 me Poloninë, që meriton të quhet padyshim më i madhi që kemi arritur në Arenën Kombëtare. Tri ndeshjet e fundit në kryeqytet nuk mund të shkonin më mirë për Shqipërisë. Një arenë që sidomos në fitoren e jashtëzakonshme ndaj Polonisë u kthye në një shtëpi, ku lojtarët dhe 22 000 tifozët u bënë një trup dhe shpirt i vetëm, shkruan "SuperSport". Emocionet dhe lumturia e përbashkët zunë vendin e polemikave dhe pesimizmit që kanë qenë të pranishme jo në pak raste gjatë viteve të fundit. Rruga drejt Gjermanisë duket e sigurt, por në fitoren ndaj Polonisë, Shqipëria rigjeti "shtëpinë" dhe lidhjen emocionale me tifozët, diçka që ishte zbehur prej vitesh.

### Ndeshjet e luajtura në "Air Albania"

Shqipëri-Francë 0-2/ 17 nëntor 2019  
Shqipëri-Lituani 0-1/ 7 shtator 2020  
Shqipëri-Kazakistan 3-1/ 15 nëntor 2020  
Shqipëri-Bjellorusi 3-2/ 18 nëntor 2020  
Shqipëri-Angli 0-2/ 28 mars 2021  
Shqipëri-Poloni 0-1/ 12 tetor 2021  
Shqipëri-Andorra 1-0/ 15 nëntor 2021  
Shqipëri-Gjeorgji 0-0/ 29 mars 2022  
Shqipëri-Izrael 1-2/ 10 qershor 2022  
Shqipëri-Estoni 0-0/ 13 qershor 2022  
Shqipëri-Islandë 1-1/ 27 shtator 2022  
Shqipëri-Itali 1-3/ 16 nëntor 2022  
Shqipëri-Armeni 2-0/ 19 nëntor 2022  
Shqipëri-Moldavi 2-0/ 17 qershor 2023  
Shqipëri-Poloni 2-0/ 10 shtator 2023

## Joshua dhe Wilderi mund të përballen në pranverë

LONDËR, 12 GUSHT - Dueli i shumëpritur i dy ish-kampionëve të botës në peshën e rëndë, britanikut Anthony Joshua dhe amerikanit Deontay Wilder, mund të zhvillohet pranverën e ardhshme. Këtë e konfirmoi promotori i Matchroom, Eddie Hearn, njëkohësisht menaxher i Joshuas. "Ne kemi një marrëveshje për ta zhvilluar këtë duel, por po saktësojmë vendin dhe datën. Nga Arabia nuk ka shumë interes, por ka vende të tjera që duan ta organizojnë këtë sfidë të



madhe. Joshua kundër Wilderit në Las Vegas, ndoshta kjo do të jetë diçka që do të mbahet mend për një kohë të gjatë", ka thënë Hearn. Edhe Anglia është një mundësi konkrete për

organizimin e kësaj sfide, që pritet të zhvillohet në mars ose prill të 2024-s. "Ka një shans që ata të duelojnë në dhjetor ose maksimumi në janar nëse arrijmë një zgjidhje të përbashkët. Por, ndoshta, do ta shtyjmë deri në mars ose prill", ka shtuar Hearn. Pritet që Wilderi të duelojë këtë nëntor dhe Joshuan në dhjetor para se të përballen vitin tjetër, por ende nuk ka datë dhe rivalë konkretë, ndaj ekziston një mundësi që ata të duelojnë këtë vit, por 99% sfida do të zhvillohet në pranverën e vitit 2024.

### SHKURT

#### Kosova pëson nga Spanja në çerekfinale

Ekipi i Kosovës në hendboll në rërë ka pësuar humbje nga Spanja në kuadër të Lojërave Mesdhetare në rërë. Ndeshja Spanjë - Kosova ishte e vlefshme për çerekfinale të ngjarjes mesdhetare. Spanjollët, që kanë përvojë të gjatë e të suksesshme në hendbollin në rërë, shënuan fitore me 2:0 (28:12, 28:13). Kosova për herë të parë po luan në ngjarje zyrtare në hendbollin në rërë dhe në Heraklion të Greqisë po fiton përvojën e duhur për të pretenduar rezultate më të mira.

#### Asllani: Milani ka ekip cilësor, por ne fitojmë

Derbi mes Interit dhe Milanit zhvillohet të shtunën në orën 18:00. Pas suksesit ndaj Polonisë, Kristjan Asllani është fokusuar tashmë me Interin, te sfida e ardhshme kundër Milanit. "Derbi? Milan është një ekip shumë cilësor dhe do të jetë një ndeshje e bukur. Ata kanë bërë një nisje të mirë, por ne jemi të fortë. Kam besim se do të bëjmë mirë dhe do të japim më të mirën për ta marrë maksimumin. Merkato? Kisha mundësi për një huazim, por pasi fola me drejtuesit, vendosa të qëndroj këtu. Interi është ëndrra ime e madhe", ka thënë Asllani.

#### Pogba del pozitiv me doping, rrezikon deri në katër vjet pezullim

Paul Pogba vijon momentin e errët te Juventusit. Mesfushori francez rezultoi pozitiv në një test dopingu që u mbajt më 20 gusht pas ndeshjes Udinese-Juventus, në të cilën ai as nuk doli në fushë. Mesfushori i Juventusit do të pezullohet si masë paraprake dhe ka tri ditë kohë për të kërkuar një kundëranalizë. Nëse testi pozitiv konfirmohet, Pogba do të gjykohej nga gjykata kombëtare anti-doping dhe rrezikon një shkualifikim dy deri katër vjet. Pas Udineses, ku nuk doli në fushë, Pogba luajti 52 minuta me Bolognën dhe Empolin, përpara se të dilte për shkak të lëndimit në ndeshjen kundër toskanëve.

#### Reali dëshiron transferimin e Mbappes në janar

Real Madridi raportohet se dëshiron që të arrijë një marrëveshje me çdo kusht në janar si parakontratë me yllin francez Kylian Mbappe para se të nënshkruajë me të përfundimisht në verën e ardhshme. Thuhet se "Los Blancos" ka ndarë një shumë prej 230 milionë eurosh (250 milionë dollarë) për yllin e Paris Saint-Germainit. Shuma do të përdoret për t'i mbuluar pagat e Mbappes dhe një tarifë nënshkrimi, sipas "Sport". Reali nuk bëri një nënshkrim të madh këtë verë për ta zëvendësuar Karim Benzeman, pasi mbeti me shpresë për ta transferuar sulmuesin e PSG-së verën e ardhshme.

#### Lewandowski refuzoi ofertat nga Arabia Saudite

Klubet nga Arabia Saudite kanë synuar edhe transferimin e Robert Lewandowskit, por sulmuesi polak nuk i ka marrë në konsideratë këto oferta. Lajmin e ka dhënë eksperti i transfereve, Fabrizio Romano. Vendimi i Lewandowskit ishte i qartë që nga dita e parë: të qëndrojë në Barcelonë dhe të luftojë për të fituar tituj me gjigantën katalunas edhe në këtë sezon. Gjatë kësaj vere dhjetëra yje të futbollit evropianë u joshën nga ofertat stratosferike të klubeve saudite duke përfunduar në gjirin e tyre. Por, Lewa i rezistoi ato oferta, duke preferuar të qëndrojë në klubin që e ëndërronte për një kohë të gjatë. Lewandowski ishte një prej sulmuesve më të mirë në Evropë në dekadën e fundit.





Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria – Vlada-Government  
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT  
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRRITUR  
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE  
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr: 964 /1  
Dt. 12.09.2023

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032, Neni 8 i Ligjit të Punës nr. 03/L-212, Neni 13 dhe 34 të Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012 (Neni 4), Udhëzimit Administrativ 05/2015, Udhëzimit Administrativ 07/2017, Udhëzimi Administrativ 05/2021 si dhe në bazë të kërkesave të shkollave, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

**RI - SHPALLJE E KONKURISIT**

Për plotësimin e vendit të lirë në Qendër e Kompetencës “11 Marsi”, në Prizren për vitin shkollor 2023/2024

| Niveli | Institucioni/Shkolla            | Vendi   | Pozita/Vend i ilirë   | Vendi i lirë/<br>Zëvendësim |
|--------|---------------------------------|---------|---|-----------------------------|
| QK     | Qendra e Kompetencës “11 Marsi” | Prizren | Një mësimdhënës/e për lëndët profesionale në profilin e Dizajnit Softuerik                        | Deri më 31.08.2024          |
| QK     | Qendra e Kompetencës “11 Marsi” | Prizren | Një mësimdhënës/e për lëndën e Matematikës - me normë të plotë                                    | Deri më 31.08.2024          |
| QK     | Qendra e Kompetencës “11 Marsi” | Prizren | Një mësimdhënës/e për lëndën e Edukatës Fizike - me normë të plotë, për mësim në gjuhën boshnjake | Deri më 31.08.2024          |

**Detyrat dhe Përgjegjësitë për mësimdhënës të nivelit të IV-të;**

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të tregojë respekt dhe të sillet me drejtësi e pa dallime me njerëzit me të cilët punon.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrës Kompetencës dhe AAAPAR-së.
- Nuk lejohet shfrytëzimi i pozitës për përfitime private në dobi të ndonjë pale të tretë.
- Diagnostifikon kushtet për mësim dhe proceseve mësimore të nxënësve përmes proceseve të përshtatshme dhe reagon në mënyrën e duhur ndaj tyre, duke filluar masa të ndryshme mbështetëse individuale ndaj nxënësve.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

**Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara për mësimdhënës:**

- Diploma e përgatitjes profesionale përkatës sipas UA (MASHTI), niveli i 7 sipas KKK;
- Letërnjoftimi (fotokopje);
- Certifikata për trajnimet e kryera;
- Vërtetimin e përvojës së punës në arsim (nëse ka);
- Për të gjitha vendet e shpallura në konkurs kërkohet përgatitja adekuate profesionale;
- Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën tryzni, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti;
- Procedurat e konkurrimit:**
  - Afati i konkurrimit është 7 ditë nga dita e shpalljes. Aplikacionet dhe dokumentet e kërkuara duhet të merren dhe dorëzohen në administratën e institucioneve në të cilat është shpallur konkursi gjegjësisht në Qendrën e Kompetencës “11 Marsi” në Prizren.
  - Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin (për të diplomuarit jashtë vendit dëshmitë e nostrifikimit të diplomës), dëshmia për përvojën e punës, dëshmia që nuk janë nën hetime dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkohen për vendin e punës.
  - Kërkesat e arritura pas mbylljes së konkursit, dhe aplikacionet e pa kompletuara nuk shqyrtohen. Kandidatët të cilët do të ftohen në intervistë duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale.

Universiteti i Prishtinës

Fakulteti Ekonomik



**Njoftim për mbrojtjen publike të punimit të doktoratës**

Njoftojmë të interesuarit se me datën 21. 09. 2023 (e enjte), në ora 11:00, në sallën e Profesorëve të Fakultetit Ekonomik, kandidatja Edona Sekiraça Idrizaj i nënshtrohet mbrojtjes publike të punimit të doktoratës, me titull **“Vlerësimi i deficitit të llogarisë rrjedhëse të bilancit të pagesave të Kosovës”**. Mentor i kandidatës dhe punimit të doktoratës është Prof. Dr. Gazmend Luboteni.

Mbrojtja e punimit të doktoratës bëhet para komisionit, në përbërje:

- Prof. dr. Safet Merovci, kryetar (Fakulteti Ekonomik, Universiteti i Prishtinës);
- Prof. ass. dr. Driton Balaj, anëtar (Fakulteti Ekonomik, Universiteti i Prishtinës) dhe
- Prof. dr. Drini Salko, anëtar i jashtëm (Universiteti Bujqësor i Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit).

Prishtinë, 13.09. 2023

**NJOFTIM**

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “RM Connect” L.L.C. me seli në Mitrovicë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrB UNIK: 812052984 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

**OBAVESTENJE**

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “RM Connect” D.O.O. od Mitrovica, donelo odluku o prestani rada sa nrB. 812052984 ujedno imenovao Likvidatora o sprovedjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

**ANNOUNCEMENT**

We inform al customers that the limited liability “RM Connect” L.L.C. with headquarters Mitrovicë, has come to the decision to quit its business: 812052984 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.





# Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



[www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

## RESTAURANT

# SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

**Lume's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Sami Makolli shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës fillore "Liria" Marec, nga kl. I-VIII.

- DPT "BYFTEK", shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit me NRB 810363789.

- FATMIR IMER IMERI, shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës fillore GJERGJ KASTRIOTI "SKENDERBEU".

- D.P.Z "ISA METAL", shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit me NRB: 810562117.

- QENDRIM PRETENI, shpall te pavlefshme dëftesat e shkollës fillore "ELENA GJIKA".

- MUHAMED HASANI B.I, shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit me NRB: 810169278.

- SAFET TAHIRI, shpall te pavlefshme diplomën e shkollës fillore "FAZLI GRAJQEFCI", ISH-SHKOLLA "29 NENTORI".

- BUTRINT IDRIZI, shpall te pavlefshme dëftesën me NR.165/2023 SHKOLLA FILLORE "EQREM ÇABEJ".

- DIELLZA VEHAPI shpall te pavlefshme dëftesat e vitit te pare dhe dyte te shkollës "TEFTA TASHKO".

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesa e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.



